

RELACION

I PROJEKTLIGJIT

“PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është një çështje thelbësore që konsiderohet me interes të lartë si brenda vendit ashtu edhe në kuadër të procesit të integrimit evropian. Aktualisht menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, i cili në vitin e miratimit të tij mbante shënimin se ligji ishte përafruar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”.

Që prej miratimit të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, Direktiva kuadër e mbetjeve, ka pësuar një sërë ndryshimesh, përkatësisht në vitet 2014, 2015, 2017, 2018 dhe 2023. Si rrjedhojë e ndryshimeve të “Direktiva kuadër e mbetjeve”, dhe akteve të tjera të BE-së për menaxhimin e mbetjeve, lind edhe nevoja e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Kjo nevojë është theksuar edhe nga Komisioni Evropian në Progres Raportin e vitit 2024 për Shqipërinë.

Në këtë kontekst, është ndërmarrë iniciativa për hartimin e një projektligji të ri për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i cili përmban një sërë ndryshimesh të rëndësishme që synojnë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Përveç synimit të përafrimit, ky projektligj synon gjithashtu rregullimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që të mundësojë ngritjen e një sistemi më efikas që është i aftë të garantojë një ulje të nivelit të ndotjes së mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN

ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TE TJERA POLITIKE

Kapitulli i mjedisit është një nga kapitujt e rëndësishëm në kuadër të procesit të integritimit, detyrimet e të cilit përcaktohen në nenin 70/3 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që parashikon domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”. Për shkak të rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit, MSA-ja përmban një nen të posaçëm për mjedisin, Nenin 108, ku përcaktohet bashkëpunimi në luftën kundër degradimit mjedisor me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore, nëpërmjet përafrimit me (Acquis e BE-së) në fushën e mjedisit.

Miratimi i këtij projektligji është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Programin Kombëtar të Integritimit European (PKIE) për vitin 2025, dhe është në përputhje edhe me Programin Politik të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Fusha e mjedisit dhe e menaxhimit të integruar të mbetjeve, ka pësuar ndryshime të konsiderueshme që nga viti 2011, kur është miratuar ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në kontekstin global dhe atë të Bashkimit Evropian, fusha e menaxhimit të mbetjeve është bërë një temë thelbësore që është zhvilluar dhe po ndjek tendenca të reja. Kjo vihet re edhe në ndryshimet e konsiderueshme që kanë pësuar aktet ligjore të BE-së (*EU Acquis*) të kapitullit 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”, përfshirë ato të nënkapitullit të mbetjeve.

Konkretisht politikat e BE-së për menaxhimin e mbetjeve po orientohen drejt tendencës së reduktimit maksimal të mbetjeve të krijuara nga veprimtaria prodhuese dhe veprimtaria e njeriut, si dhe drejt riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që shkon në landfille. Në këtë kontekst është vendosur theksi mbi zbatimin optimal të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve edhe nëpërmjet politikave ekonomike dhe instrumentave të tjera ndihmëse që shteti vë në dispozicion për të arritur këto qëllime.

Për këtë arsye u hartua ky projekt ligj për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i cili ka për synim të përforcojë nivelin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me EU Acquis në fushën e menaxhimit të mbetjeve nga njëra anë dhe nga ana tjetër të përmirësojë dhe të fuqizojë sistemin e brendshëm të menaxhimit të mbetjeve.

Pra, përveç operacionit të përafrimit të dispozitave të ligjit shqiptar me ato të EU Acquis, ky projektligj përmban edhe dispozita që kanë për synim të rregullojnë ato aspekte të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri që mbeteshin të pa rregulluara, ose të paqarta.

Kështu për herë të parë projektligji përmban dispozita në lidhje me sistemin e grumbullimit të mbetjeve që ngrihet nga bashkitë. Gjithashtu, projektligji parashikon rregullimin e zonave të menaxhimit të mbetjeve dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Vlen për t'u përmendur se projektligji kujdeset gjithashtu që të harmonizohet me legjislacionin shqiptar ekzistues dhe veçanërisht me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar. Kështu të gjitha dispozitat e projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, janë tërësisht në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe respektojnë funksionet e bashkive dhe parimin e autonomisë së qeverisjes vendore.

Projektligji u publikua në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP) nga data 20.08.2024 deri me datë 17.09.2024.

Ky projektligj është diskutuar edhe në disa dëgjesa publike gjatë të cilave u prezantuan pikat kryesore të projektligjit, u zhvilluan diskutime dhe u mblodhën sugjerimet e pjesmarrësve dhe konkretisht:

- i. Dëgjesa publike e datës 6 Nëntor 2024 me organizatat mjedisore.
- ii. Dëgjesa publike e datës 11 Nëntor 2024 me donatorët.
- iii. Dëgjesa publike e datës 13 Nëntor 2024 me bashkimin e prodhuesve të Shqipërisë.
- iv. Dëgjesa publike e datës 15 Nëntor 2024 me përfaqësuesit e qeverisjes vendore të Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMERISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është harmonizuar me Kodin e Procedurave Administrative, me legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe me legjislacionin për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji dhe aktet që do të miratohen në zbatim të tij, synon që të arrijë një shkallë të lartë përafrimi me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva”.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.

Projektligji përmban gjithsej 85 nene, të përfshirë në njëmbëdhjetë krerë. Projektligji përmban gjithashtu 7 shtojca.

KREU I – Dispozita të Përgjithshme, përmban dispozitat me karakter të përgjithshëm, mbi qëllimin, objektin dhe fushën e veprimit të ligjit, përjashtimet nga fusha e veprimit, përkufizimin e termave dhe parimet e përgjithshme. Në këtë kre, përfshihen gjithashtu, parashikime të përgjithshme mbi hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, mbi nënproduktet, mbi fundin e statusit mbetje dhe katalogun e mbetjeve.

Disa rregullime ligjore të përfshira tek Kreu I – Dispozita të përgjithshme, vlejné të shpjegohen më hollësisht në këtë relacion.

Tek neni 4 përkufizimet, janë shtuar një sërë përkufizimesh të reja si pasojë e ndryshimeve të Direktivës kuadër të mbetjeve me të cilën projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve synon përafrim të rëndësishëm. Ndryshimet më thelbësore në këtë aspekt janë si më poshtë :

i. Përkufizimi i termit mbetje bashkiake është shtuar në projektligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve si pasojë e përfshirjes së tij në Direktivën kuadër të mbetjeve në vitin 2018. Ky ndryshim i direktivës u bë sepse u konsiderua e nevojshme që të zbatohet i njëjti përkufizim i mbetjeve bashkiake në nivel evropian në mënyrë që të dhënat statistikore të mbledhura nga shtetet anëtare të ishin të sakta dhe të krahasueshme. Kështu përkufizimi i ri ‘mbetjet bashkiake’ parashikon në mënyrë të qartë llojet e mbetjeve që konsiderohen mbetje bashkiake dhe përjashton shprehimisht nga mbetjet bashkiake disa rryma mbetjesh si mbetjet nga prodhimi, mbetjet nga ndërtimi dhe shembja, etj., të cilat përkufizohen më vete dhe trajtohen ndryshe. Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka ndjekur të njëjtën qasje të direktivës duke parashikuar përkufizimin e ri të ‘mbetjeve bashkiake’ në përputhje të plotë me përkufizimin e direktivës.

ii. Për shkak të përkufizimit të ri ‘mbetje bashkiake’ ka ndryshuar edhe përkufizimi i termit ‘mbetje shtëpiake’ që parashikohej tek ligji Nr.10 463,

datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Përkufizimi i ri i termit 'mbetje shtëpiake' është një nënkategori e mbetjeve bashkiake dhe është shtuar për të bërë dallimin mes mbetjeve bashkiake me prejardhje nga shtëpitë dhe mbetjeve bashkiake me prejardhje nga sektorë të tjerë.

- iii. Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka parashikuar gjithashtu si përkufizim të ri, përkufizimin e 'mbetjeve nga ndërtimi' si rrymë e posaçme mbetjesh, e përjashtuar nga koncepti i mbetjeve bashkiake, në përputhje të plotë me ndryshimet e vitit 2018 të Direktivës kuadër të mbetjeve.
- iv. Një tjetër përkufizim i ri i projektligjit që rrjedh nga ndryshimet e direktivës kuadër të mbetjeve është përkufizimi i skemës së përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit që mungonte në variantin origjinal të direktivës të vitit 2008. Përfshirja e këtij përkufizimi erdhi si nevojë për të qartësuar skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, në kuadër të dispozitave të reja që iu shtuan direktivës në vitin 2018.

Koncepti i përparësisë së menaxhimit të mbetjeve ose hierarkia e mbetjeve nuk ka ndryshuar edhe pas ndryshimeve të Direktivës kuadër të mbetjeve, por u përforcua nëpërmjet përshtatjes së një sërë instrumentash ekonomike dhe masash të tjera që mund të përdoren nga shtetet për realizimin e hierarkisë së mbetjeve. Kështu neni 6 i projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve vazhdon të parashikojë të njëjtën hierarki të menaxhimit të mbetjeve të përcaktuar edhe nga ligji Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Ndryshimi është që tashmë projektligji, në përputhje me ndryshimet e direktivës parashikon edhe një shtojcë që përcakton instrumentat ekonomikë dhe masat e tjera që nxisin zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të integruar të mbetjeve.

KREU II – Kërkesa të Përgjithshme: Ky kre përmban kërkesat e përgjithshme që zbatohen për të gjitha operacionet që bëjnë pjesë në hierarkinë e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Kështu ky kre rregullon parandalimin e mbetjeve, përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve, rikuperimi i mbetjeve, dhe objektivat e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve si dhe asgjësimin e mbetjeve.

Neni 10 Parandalimi i mbetjeve: Vlen të theksohet se dispozita për parandalimin e mbetjeve e Direktivës kuadër të mbetjeve ka ndryshuar rrënjësisht në vitin 2018. Varianti i mëparshëm i direktivës parashikonte kryesisht disa detyrime të Komisionit për të hartuar raporte, për të propozuar masa dhe objektiva. Ndërsa dispozita e re e Direktivës kuadër të mbetjeve përcakton tashmë detyrimin e shteteve anëtare për të marrë masa konkrete që parandalojnë krijimin e mbetjeve. Gjithashtu, në dispozitën e re të direktivës përcaktohen detyrimet e

shteteve për monitorimin dhe vlerësimin e masave të parandalimit të mbetjeve dhe metodat e monitorimit. Gjithashtu dispozita e direktivës përmend shprehimisht masa për pakësimin e mbetjeve nga ushqimi si p.sh nxitjen e dhurimit të ushqimit, si dhe forma të tjera të rishpërndarjes së ushqimit. Kjo është me rëndësi, pasi tema e mbetjeve është me shumë interes në Bashkimin Evropian dhe trajtohet edhe tek propozimi për ndryshime të Direktivës kuadër të mbetjeve të vitit 2023, që ende nuk është miratuar. Në këtë kontekst edhe dispozita e legjislacionit shqiptar për parandalimin e mbetjeve ka pësuar ndryshime domethënëse dhe përkatësisht është parashikuar hartimi i programit kombëtar për parandalimin e mbetjeve si pjesë e veçantë e planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve. Në këtë plan, do të përcaktohen objektivat konkrete për parandalimin e mbetjeve, aktivitetet dhe afatet për zbatimin e tyre në linjë me parashikimin e direktivës.

Përgatitja për ripërdorim dhe riciklimi i mbetjeve: Edhe kjo dispozitë e përgatitjes për ripërdorim dhe riciklim e Direktivës kuadër të mbetjeve ka pësuar ndryshime të qenësishme në vitin 2018. Në lidhje me **grumbullimin e diferencuar**, varianti i vjetër i direktivës parashikonte grumbullimin e diferencuar të paktën për letrën, metalin, plastikën dhe qelqin. Pas ndryshimeve, detyrimi i grumbullimit të diferencuar shtrihet edhe për rryma të reja mbetjesh si mbetjet bio (duke nisur nga 31 Dhjetori i vitit 2023), mbetjet tekstile dhe fraksionet e mbetjeve të rrezikshme të krijuara nga shtëpitë (duke nisur nga 1 Janari i vitit 2025). Në këto kushte edhe dispozita e projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka ndryshuar, duke parashikuar në ligj detyrimin e përgjithshëm për të grumbulluar mbetjet në mënyrë të diferencuar, pa bërë ndonjë dallim mes rrymave specifike të mbetjeve dhe duke përcaktuar se masat, procedurat dhe afatet për zbatimin e grumbullimit të diferencuar për të gjitha rrymat e mbetjeve do të përcaktohen konkretisht me Vendim të Këshillit të Ministrave. Risia e projektligjit është se parashikohet shprehimisht se njësitë e qeverisjes vendore do të konsultohen për masat, procedurat, kriteret dhe afatet e grumbullimit të diferencuar të rrymave të mbetjeve. Në këtë mënyrë garantohet pjesëmarrja aktive e NJVV-ve, të cilat janë institucionet e ngarkuara me kryerjen e funksioneve të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Neni 13 Objektivat dhe metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklimin dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve

Direktiva kuadër e mbetjeve por edhe disa akte të tjera të BE-së të rëndësishme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përcaktojnë një sërë objektivash për

ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve si dhe metodologjinë e llogaritjes së përmbushjes së tyre. Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikon se në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve përcaktohen objektivat e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të rrymave të mbetjeve. Metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave dhe viti në të cilin fillon detyrimi për përmbushjen e objektivave si dhe afatet e ndërmjetme do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14 – Asgjësimi i mbetjeve: Asgjësimi i mbetjeve vazhdon të mbetet operacioni i menaxhimit të mbetjeve, që duhet të përdoret si opsion i fundit. Ky parim theksohet edhe në projektligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Edhe në rastin e asgjësimit është përcaktuar se objektivat për reduktimin e operacioneve të asgjësimit të mbetjeve, do të parashikohen në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

KREU III – Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve, përmban rregullimin e të gjithë sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky kre përbëhet nga shtatë seksione.

Seksioni I – Përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ka si synim të rregullojë ndarjen e përgjegjësisë për menaxhimin e integruar të mbetjeve mes aktorëve kryesorë të këtij procesi që janë krijuesi dhe zotëruesi i mbetjeve, prodhuesi i produkteve që i nënshtrohet përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, bashkive dhe AKEM si institucionet e ngarkuara me funksionin e menaxhimit të mbetjeve.

Seksioni II – Institucionet përgjegjëse, ka si synim të përcaktojë institucionet përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe të përcaktojë detyrat dhe kompetencat e tyre. Risia e projektligjit është detajimi i kompetencave të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM), si një institucion i krijuar rishtazi si menaxhues i infrastrukturës fundore të trajtimit të mbetjeve që janë në administrimin e tij si dhe renditja e hollësishme e kompetencave të bashkive për organizimin dhe funksionimin e ndarjes së mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar të mbetjeve dhe transportin deri në infrastrukturën fundore të trajtimit të tyre. Kompetencat e bashkive janë përcaktuar në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe me funksionet që sipas atij ligji kanë bashkitë në fushën e menaxhimit të mbetjeve duke sjellë kështu edhe një harmonizim mes dy ligjeve.

Seksioni III – Zonat e menaxhimit të mbetjeve, është një nga risitë e projekt ligjit. Sipas këtij seksioni, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në disa zona brenda të cilave kryhet menaxhimi i integruar i mbetjeve në nivel ndërvendor.

Kjo ndarje ekzistonte edhe më parëpor projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve vendos në ligj parimet për identifikimin dhe ngritjen e zonave të menaxhimit të mbetjeve.

Risia e dytë e rëndësishme e projektligjit është që rregullon mënyrën sesi bashkitë e përfshira brenda një zonë dhe AKEM do të bashkëpunojnë për menaxhimin e mbetjeve. Kjo rregullohet nga dispozita mbi bashkëpunimin ndërvendor dhe AKEM, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërvendor. Është tek kjo marrëveshje që do të përcaktohen konkretisht struktura organizative dhe metodat e menaxhimit të përbashkët të mbetjeve, që do të ngrihen nga AKEM dhe bashkitë që bëjnë pjesë në zonën e menaxhimit të mbetjeve. Në këtë marrëveshje përcaktohen çështje kryesore si struktura administrative e zonës, detyrimet për ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, kontributet financiare të secilës bashki, mbledhja e të ardhurave, ndarja e detyrave etj.

Seksioni IV – Kostot dhe instrumentat ekonomikë dhe masat e tjera nxitëse, përmban disa dispozita që rregullojnë aspekte të rëndësishme të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në këtë seksion së pari rregullohet ndarja e kostove për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në linjë me ndryshimet e Direktivës kuadër të mbetjeve, parashikohen një sërë instrumentash ekonomike dhe instrumenta të tjera të cilat shërbejnë si masa nxitëse për zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu në këtë seksion është krijuar Fondi i ekonomisë së mbetjeve, i cili është një fond i posaçëm i ngritur me qëllim mbështetjen e politikave, programeve dhe projekteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Seksioni V – Operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, përmban një sërë nenesh që rregullojnë në mënyrë të hollësishme operacionet e menaxhimit të mbetjeve.

Risi e këtij seksioni është shtimi i një dispozite mbi grumbullimin e mbetjeve nga bashkitë. Kjo veprimtari nuk është e rregulluar nga Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar. Ndihej veçanërisht mungesa e dispozitës në lidhje me ngritjen e sistemit të grumbullimit të mbetjeve nga bashkitë, një hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiake. Dispozita e grumbullimit vendos disa parime / standarde të përgjithshme për sistemin e grumbullimit bashkiak duke respektuar plotësisht autonominë vendore dhe parashikimet e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Rregullime të tjera të reja të projektligjit janë dispozita për ruajtjen parprake, dispozita për stacionet e transferimit dhe dispozita për transportin e mbetjeve jo të rrezikshme.

Seksioni VI – Menaxhimi i integruar i mbetjeve të rrezikshme, përmbledh në një seksion të posaçëm të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me operacionet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, etiketimin, transportin dhe dorëzimin e tyre.

Seksioni VII – Normat teknike minimale, përmban dispozitën me parashikime mbi normat teknike minimale për të gjitha operacionet e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

KREU IV – Rrymat specifike të mbetjeve: Ky kre përmban rregullime mbi rrymat specifike të mbetjeve dhe përkatësisht në lidhje me: vajrat e përdorura; mbetjet bio; ambalazhet dhe mbetjet e ambalazheve; produktet plastike një përdorimshe; ndotësit organik të qëndrueshëm; bateritë dhe mbetjet e baterive; automjetet në fund të jetës; mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike; mbetjet spitalore; mbetjet e nënprodukteve shtazore; mbetjet nga ndërtimi; mbetjet e industrisë së dioksidit të titanit; mbetjet nga anijet dhe nga tepricat e ngarkesave; mbetjet nga gomat e përdorura. Vlen të theksohet se dispozitat e këtij kreu, nuk zëvendësojnë rregullimet e legjislacionit të posaçëm mbi rrymat specifike të mbetjeve dhe janë në përputhje dhe në harmoni me to.

KREU V – Strategji, plane dhe programe: ky kre parashikon instrumentat e planifikimit të shtetit shqiptar në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Dokumenti strategjik dhe planifikues kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve është **Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Strategjia kombëtare)**. Neni 62 i Kreut V rregullon disa parashikime të përgjithshme për strategjinë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve, ndërsa struktura dhe përmbajta specifike e strategjisë kombëtare parashikohet në Shtojcën 4 të ligjit.

Neni 63 i Kreut V parashikon një tjetër plan kombëtar për menaxhimin e mbetjeve, planin kombëtar sektorial të menaxhimit të mbetjeve (Masterplanin). Ky plan rregullon kryesisht aspektin territorial të menaxhimit të mbetjeve, përfshirë përcaktimin e zonave të menaxhimit të mbetjeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve. Për shkak se Masterplani ka të bëjë me aspektet e zhvillimit të territorit dhe infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, projektligji parashikon se ai miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Dispozitat vijuese rregullojnë planet zonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe procedurat për miratimin e tyre. Neni 66 rregullon programet për parandalimin e krijimit të mbetjeve dhe parashikon miratimin e programit kombëtar për parandalimin e krijimit të mbetjeve që përmban objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat për realizimin e parandalimit. Programi Kombëtar i Parandalimit të Mbetjeve është pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare.

KREU VI – Licencimi, përmban dispozita në lidhje me licencimin e operacioneve të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Këto dispozita kryesisht i referohen legjislacionit specifik për licencimin në fushën e mjedisit dhe përkatësisht ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10488 datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

KREU VII – Inspektimi, kërkesa për mbajtjen e të dhënave dhe raportimet, përmban dispozita që rregullojnë inspektimin, mbajtjen e të dhënave dhe raportimet.

KREU VIII – Lëvizja ndërkufitare e mbetjeve, rregullon importin dhe eksportin e mbetjeve, kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme si dhe lejet dhe autorizimet e nevojshme për lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve. Neni 72 i projektligjit mbi importin e mbetjeve ndalon importin e të gjitha mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, duke vazhduar në gjurmët e legjislacionit në fuqi.

KREU IX – Kundërvajtjet administrative, parashikon ndalimet, sanksionet dhe masat në rastet e shkeljeve të lejeve të mjedisit, kundërvajtjet administrative, si dhe dispozita në lidhje me ankimin dhe ekzekutimin.

KREU X – Dispozita rregulluese, përmban parashikimet për lendfillet ekzistuese për të mundësuar kryerjen pa shkelje të operacioneve të menaxhimit të integruar të mbetjeve në periudhën tranzitore të miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit të ri për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

KREU XI – Dispozita kalimtare dhe përfundimtare, përmban parashikimet për aktet nënligjore që do të miratohen në zbatim të ligjit, vazhdimin e efekteve të disa akteve nënligjore ekzistuese, dispozitat kalimtare, shfuqizimet dhe hyrjen në fuqi.

SHTOCJAT – Siç u përmend edhe më sipër projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka një numër shtojcash, që rregullojnë aspektet më teknike të dispozitave ligjore.

Shtojca 1 – Operacionet e asgjësimit, përmban një listë jo shteruese me operacione të menaxhimit të integruar të mbetjeve që bëjnë pjesë në konceptin e operacioneve të asgjësimit të mbetjeve. Jo të gjitha operacionet e asgjësimit të përmendura në Shtojcën 1 të ligjit janë operacione që kryhen në Shqipëri. Aty përmenden edhe operacione që në fakt nuk lejohet të kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose në vendet e Bashkimit Evropian, siç është operacioni i incinerimit të mbetjeve në det. Për këtë arsye, Shtojca 1 ka efekt ilustrues dhe shpjegues për të kuptuar konkretisht cilat lloje veprimtarish përfshihen në konceptin e asgjësimit sipas Direktivës kuadër të mbetjeve dhe sipas projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Shtojca 2 – Operacionet e rikuperimit, gjithashtu përmban një listë ilustruese me operacione që bëjnë pjesë në konceptin e operacioneve të rikuperimit. Edhe për këtë shtojcë vlen i njëti parim, pra që jo të gjitha operacionet e përmendura në shtojcë kryhen patjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Edhe kjo shtojcë ka efekt ilustrues dhe shpjegues.

Shtojca 3 – Vetitë e mbetjeve që i klasifikojnë ato si të rrezikshme, përshkruan disa veti të mbetjeve që i bëjnë ato të kategorizohen si mbetje të rrezikshme.

Shtojca 4 – Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit i për menaxhimin e integruar të mbetjeve, parashikon strukturën dhe përmbajtjen e detyrueshme të planit kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

Shtojca 5 – Programet e parandalimit të mbetjeve, është shtuar si pasojë e ndryshimeve të dispozitës për parandalimin e mbetjeve dhe përmban disa parashikime të programeve për parandalimin e mbetjeve.

Shtojca 6: Shembuj të instrumentave ekonomikë dhe masave të tjera për të nxitur zbatimin e hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve, është shtuar në përputhje me ndryshimet e Direktivës kuadër të mbetjeve, e cila ka parashikuar një shtojcë me shembuj të instrumentave ekonomikë dhe masave të tjera që nxisin zbatimin e hierarkisë së mbetjeve. Kjo shtojcë shërben si udhërrëfyes për instrumentat ekonomikë dhe masat e tjera që shteti shqiptar ka në dispozicion dhe mund të përdorë për të realizuar hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve.

Shtojca 7: Plani zonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përmban elementët minimalë që duhet të përmbajë një plan i tillë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij ligji.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me asistencën e ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë, nga Agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtarë (GIZ) Albania, në kuadër të projekti IPA “BE për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër”. Projektligji u dërgua për mendim nëpërmjet sistemit e-akte tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, AKSHI dhe në mënyrë shkresore tek Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshilli Konsultativ i saj dhe tek Shoqata për Autonomi Vendore, të cilët janë shprehur si më poshtë:

Ministria e Drejtësisë është shprehur me komente si vijon:

1. Të rishikohen nenet 1 dhe 2 të projektligjit, me qëllim qartësimin nëse nëpërmjet këtij projektligji do të krijohet sistemi i menaxhimit të integruar të mbetjeve, apo do të përcaktohen rregullat për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Bazuar në sugjerimin e mësipërm janë rishikuar dhe riformuluar nenet 1 dhe 2 në funksion të qartësisë të dispozitave që shprehin qëllimin dhe objektin e ligjit.
2. Lidhur me komentin që në pikën 4, të nenit 3, të projektligjit, të specifikohen se cilat do të jenë aktet e tjera ligjore që mund të përcaktojnë rregulla specifike për raste të veçanta ose dispozita plotësuese të këtij ligji, mbi menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, sqarojmë se u rishikua përmbajtja e kësaj pike dhe u hoq si parashikim i panevojshëm në këtë nen.
3. Lidhur me komentin që në pikën 52, të nenit 4, të projektligjit, për aq sa është e mundur, të përcaktohet lista shteruese e operacioneve të rikuperimit të parashikuar në shtojcën 2, bashkëlidhur projektaktit, sqarojmë se teknikisht është e pamundur të përcaktohet një listë shteruese e operacioneve të rikuperimit për shkak të teknologjisë ekzistuese të këtyre operacioneve, e cila është në proces të vazhdueshëm zhvillimi dhe mund të sjellë në të ardhmen operacione të reja rikuperimi. Për rrjedhojë, 50 shkronja “b” e nenit 4 (që i korrespondon pikës 52 të mëparshme) u riformulua në funksion të qartësisë.
4. Sa i përket komentit që në nenin 6, të projektligjit togfjalëshi “hierarkia e mbetjeve”, të zëvendësohet me togfjalëshin “hierarkia e trajtimit të mbetjeve”, sqarojmë se përdorimi i këtij togfjalëshi është në harmonizim me terminologjinë e përdorur në direktivën përkatëse të mbetjeve. Për më tepër, një nga proceset e hierarkisë së mbetjeve, si “parandalimi i mbetjeve” nuk përfshihet në trajtimin e mbetjeve, referuar edhe përkufizimit në pikën 63, të nenit 4 të projektligjit. Në këto kushte, vlerësojmë që përdorimi i këtij togfjalëshi është i qartë dhe nuk

është e nevojshme zëvendësimi me togfjalëshin “hierarkia e trajtimit të mbetjeve”.

5. Për sa i përket komentit që në pikën 1, të nenit 10, të projektaktit, të rishikohet togfjalëshi “prioriteti i parë”, në kushtet kur secili prej elementëve të parashikuar në hierarkinë e trajtimit të mbetjeve, ka prioritetin përkatës, sipas renditjes në nenin 6, të projektligjit, sqarojmë se u mor në konsideratë dhe pika 1 e nenit 6 u hoq nga përmbajtja e nenit, si parashikim jo i domosdoshëm që krijon përsëritje.

6. Sa i përket komentit që për nenet 11 dhe 12 të projektligjit, të rishikohet terminologjia e përdorur në përputhje me termat e parashikuar në nenin 6, sqarojmë se nenet u rishikuan dhe u riformuluan parashikimet e këtyre neneve si në përmbajtje ashtu edhe në renditje të dispozitave bazuar në hierarkinë e mbetjeve të parashikuar në nenin 6 të këtij ligji.

7. Për komentin 7 sipas të cilit objektivat kryesorë të projektatit duhet të përmbahen në projektligj dhe jo në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sqarojmë se është riformuluar tërësisht përmbajtja e nenit 13 ku është përcaktuar që objektivat kryesorë janë pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në përputhje me parashikimet e nenit 100 të Kushtetutës dhe legjislacionin evropian për mbetjet, i cili rishikohet herë pas here duke sjellë si pasojë edhe ndryshimin e objektivave. Për këtë arsye, instrumenti ligjor më i përshtatshëm për parashikimin e objektivave specifike në fushën e mbetjeve është konsideruar Strategjia dhe plani i veprimit, të cilët miratohen me VKM dhe mund të përditësohen më lehtësisht, ndërkohë që kriteret për përcaktimin e metodologjisë së përlllogaritjes së përmbushjes së objektivave janë pjesë përbërëse e këtij neni.

8. Lidhur me komentin për nenet 15, 16, dhe 17, të projektligjit sqarojmë se janë rishikuar dispozitat dhe janë riformuluar në funksion të qartësisë dhe shmangies së mbivendosjeve me parashikimin e projektligjit për PZP. Konkretisht në nenin 15 janë specifikuar subjektet që në nënshtrohen zbatimit të këtij ligji dhe që janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve, si:

- i. Krijuesi i mbetjeve, ku bëjnë pjesë të gjithë personat që krijojnë mbetje;
- ii. Subjektet prodhues që nënshtrohen përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, vetëm për rrymat e mbetjeve që përcaktohen nga ligji i posaçëm.
- iii. Bashkitë për mbetjet bashkiake.

Për secilin subjekt ligji parashikon detyrime dhe përgjegjësi të ndara, nuk parashikohet bashkë ekzistenca e dy skemave njëkohësisht dhe prodhuesi që nënshtrohet PZP nuk ka diskrecion të zgjedhë njëren skemë apo tjetrën. Detyrimet

e prodhuesit të PZP përcaktohen nga ligji i posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit sipas parashikimeve specifike që ai ligj përmban për rrymat e caktuara të mbetjeve dhe skemat e PZP. Kjo përcaktohet edhe në nenin 17 të projektligjit i cili parashikon që PZP dhe skemat përkatëse rregullohen me ligj të posaçëm. Neni 17 i projektligjit nuk hyn në rregullime të hollësishme, duke ja lënë ato ligjit të posaçëm të PZP, prandaj nuk kemi asnjë mospërputhje apo mbivendosje mes të dy ligjeve. Përkundrazi, projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve si ligj kuadër, është harmonizuar duke u bërë një urë lidhëse me ligjin e posaçëm për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit.

9. Për komentin në lidhje me ngritjen e AKEM-it, si një institucion që do të mundësojë tranzicionin në modelin e ekonomisë qarkulluese, të parashikuar në nenin 22, të projektligjit, sqarojmë se ky nen u riformulua në funksion të qartësisë së tij, duke parashikuar AKEM si institucion publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin.

10. Në lidhje me komentin 10, sipas të cilit në nenin 24, të këtij projektligji, në pikën 2, shkronja “a”, parashikohet se Bashkitë kanë në kompetencë, grumbullimin e mbetjeve bashkiake dhe të rrymave të tjera të mbetjeve të caktuara, në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore zbatuese. Referuar parashikimeve të këtij neni në raport me parashikimet e nenit 23, pika 10, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, bashkitë janë përgjegjëse për “Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake”. Në këto kushte, sjellim në vëmendjen tuaj që parashikimet e këtij neni tejkalojnë rregullimet ligjore sipas përcaktimeve të nenit 23, pika 10, të ligjit nr.139/2015, të ndryshuar, pasi ligji nr. 139/2015 përcakton funksionet e bashkive pa përkufizuar kuptimin e termave mbledhje, largim, trajtim etj. Kjo është një karakteristikë e ligjit 139/2015, i cili si ligj kuadër përcakton funksionet duke lënë që përkufizimi i termave konkret të jepet në ligjet sektoriale të secilës fushë. Në këtë rast përkufizimi i termave mbledhje, largim dhe trajtim përcaktohen në ligjet sektoriale që janë aktualisht ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe ligji nr. Nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”. Sipas këtij të fundit “largimi i publik i mbeturinave” quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbeturinave. Pra sipas legjislacionit aktual në fuqi grumbullimi është funksion i bashkive sepse përfshihet nën konceptin e largimit të mbeturinave. Në të njëjtën mënyrë ligji në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve parashikon se “grumbullim” është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në

impiantet e përpunimit të mbetjeve. Në të njëjtën linjë është edhe projektligji që parashikon se ““Grumbullim” është mbledhja, përfshirë ndarja paraprake dhe ruajtja paraprake e mbetjeve me qëllim transportimin e tyre në impiantet e trajtimit të mbetjeve.” Edhe në këtë rast jemi brenda funksioneve të parashikuara për bashkitë nga ligji 139/2015, sipas të cilit mbledhja është gjithashtu funksion i bashkive. Pra projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve nuk shton asnjë funksion të ri për bashkitë të cilat vazhdojnë të kenë funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit, por thjesht harmonizon terminologjinë e përdorur nga ligji 139/2015 me përkufizimet e reja që janë të nevojshme në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivën kuadër të mbetjeve.

11. Sa i takon komentit 11, për rishikimin e parashikimeve të shkronjave “d” dhe “ë”, të nenit 24, të projektligjit, me qëllim shmangien e dispozitave të cilat në thelb kanë të njëjtat rregullime, ju bëjmë me dije se ky sugjerim u mor në konsideratë dhe u reflektua në tekstin e projektligjit, ku shkronja (d) u hoq nga përmabajtja e nenit dhe shkronja (ë) e po këtij neni u riformulua në: *“ë) organizimin dhe mbështetjen e skemave dhe fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për menaxhimin e mbetjeve me fonde publike dhe burime të tjera të ligjshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe masave konkrete për parandalimin e mbetjeve brenda territorit të bashkisë”*;

12. Në lidhje me komentin 12, sipas të cilit meqënëse shkronja “f” e nenit 24 trajton detyrimin e informimit nga bashkia tek Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve ndërsa neni 23, shkronja “a” e të njëjtë projektligj përcakton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si institucionin përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe analizimin e të dhënave mbi krijimin dhe trajtimin e mbetjeve, sugjerohet që detyrimi për informim të kryhet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ky rekomandim të vlejë për të gjitha dispozitat e tjera që parashikojnë informim dhe raportim, sqarojmë se ka një ndryshim mes të dhënave të mbledhura nga AKM dhe të dhënave të mbledhura nga Bashkitë. AKM mbledh të dhëna në nivel kombëtar nga të gjithë operatorët e pajisur me licenca dhe leje mjedisi që kryejnë veprimtari të menaxhimit të mbetjeve. Ndërsa bashkitë mbledhin të dhëna në nivel territorial, pra vetëm për mbetjet që krijohen dhe trajtohen brenda territorit të bashkisë. Kjo shprehet qartë në shkronjën (f) të nenit 24 si dhe në nenin 71 të projektligjit. Mbledhja e të dhënave në nivel territorial u shërben bashkive dhe AKEM-it për të kryer një vlerësim të situatës së mbetjeve në territorin e bashkive dhe në zonat e menaxhimit të mbetjeve ku bashkitë bëjnë pjesë, në mënyrë që të jetë më e lehtë të planifikohen masat e nevojshme për grumbullimin e diferencuar, për ngritjen e infrastrukturës etj. Kjo ndarje nuk i cënon kompetencat e AKM-së. E njëjta logjikë vlen edhe për nenin

71 të projektligjit që parashikon ndarjen e kompetencave mes AKM-së dhe AKEM-it mbi mbledhjen e të dhënave.

13. Sa i përket komentit për parashikimin e shkronjës “c”, pika 3, e nenit 24, të projektligjit, ku skema e funksionimit të menaxhimit të mbetjeve sa i takon mbetjeve të bashkive është e përcaktuar se do të realizohet nëpërmjet shoqërive të përgjegjëse të zgjeruara të prodhuesve dhe themelimi i personave juridik publikë për ushtrimin e këtyre funksioneve sipas këtij parashikimi të projektligjit tejkalon parashikimet e projektligjit për përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit, sqarojmë seneni 24 rradhit përgjegjësitë e bashkive, mes të cilave përgjegjësinë për ngritjen e të gjithë sistemit bashkiak të grumbullimit të mbetjeve (Neni 24 paragrafi (2) shkronja (ç) e projektligjit). Në këtë kontekst, neni 24 (3) (c) parashikon instrumentat ligjore që kanë bashkitë për ngritjen e sistemeve. Këto instrumenta parashikohen edhe nga ligji 139/2015 dhe janë rradhitur për qartësi edhe në projektligjin e mbetjeve. Kështu bashkitë për ngritjen e sistemit të grumbullimit dhe kryerjen e operacioneve të trajtimit mund të përdorin njësitë administrative ekzsituase, mund të krijojnë njësi të reja administrative/institucione, mund të krijojnë edhe persona juridikë publikë ose mund të lidhin kontrata me privatët. Ndërsa neni i PZP i referuar dhe analizuar nga MD përcakton bashkëpunimin mes bashkive dhe subjekteve prodhues të PZP për ngritjen e infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, për ato rryma mbetjesh që i nënshtrohen PZP. Pra, nëse do të ngrihen pika specifike për grumbullimin e rrymave të mbetjeve që i nënshtrohen PZP-së, p.sh shisheve plastike, këto pika mund të bashkëfinancohen nga Bashkia dhe PZP. Ky parashikim nuk ka asnjë mbivendosje dhe asnjë kontradiktë me nenin 24 paragrafi (3) shkronjën (c) të projektligjit. Bashkia do të veprojë me strukturën e vet, të ngritur lirisht sipas nenit 24 (3) (c) të projektligjit dhe ligjit 139/2015, dhe kjo strukturë (qoftë institucion ose person juridik publik) sëbashku me prodhuesin e PZP do të marrë vendimin për të ngritur infrastrukturën për grumbullimin e diferencuar p.sh të shisheve, që do të financohet 50% nga struktura e bashkisë dhe 50% nga prodhuesi PZP.

14. Në lidhje me komentin e MD mbi parashikimit të nenit 29, të projektligjit, për fondin e ekonomisë së mbetjeve sqarojmë se ky nen ka ndryshuar dhe është riformuluar tërësisht duke marrë parasysh sugjerimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të ministrisë së financave.

15. Për komentin referuar shkronjës “dh”, të pikës 7, të nenit 34, të projektligjit, ku sugjerohet të mbahet në konsideratë që procedurat, kërkesat dhe standardet për trajtimin e mbetjeve që do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të jenë të ezauruara në përmbajtje të këtij neni, i cili do të shërbejë si autorizim ligjor

për miratimin e projektvendimit përkatës, sqarojmë se, komenti u mor në konsideratë ku, në funksion të përcaktimit të qartë të dispozitës autorizuese për nxjerrjen e akteve nënligjore sipas parashikimeve të nënparagrafëve të pikës 7, fjalia hyrëse e nenit 7 u riformulua, duke përcaktuar elementët që do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave si dhe u riformulua pika 7 e nenit 7 në funksion të qartësisë për dispozitën që do të miratohet nga Këshilli i Ministrave. U riformulua shkronja “dh”, e pikës 7, të nenit 34 të projektligjit duke e bërë atë ezauruese.¹⁶ Lidhur me komentin për nenin 35 të projektligjit, për zëvendësimin e togefjalëshit dhe riformulimin e pikës 1 dhe 2, të këtij neni, në kushtet kur një dispozitë nuk mund të fillojë në formë mohuese, sqarojmë se u mor në konsideratë dhe u riformulua ky nen.¹⁷ Për komentin që pika 4, e nenit 36, të projektligjit duhet të përcaktojë në mënyrë shteruese se cilat rregulla dhe procedura do të miratohen konkretisht, në kushtet kur kjo dispozitë do të shërbejë si autorizim ligjor për miratimin e një projektvendimi, sqarojmë se u mor në konsideratë dhe u reflektua në përmbajtje të këtij neni.

18. Për komentin që, në pikën 2, të nenit 44, të projektligjit, të përcaktohen të gjitha aktet ligjore apo nënligjore në fuqi mbi të cilat duhet të mbështetet transporti i mbetjeve të rrezikshme, sqarojmë se pika 2 u hoq nga përmbajtja e këtij neni sepse u konsiderua deklarative.

19. Në lidhje me komentin për pikën 5, të nenit 47, të projektligjit, sipas të cilit vajrat e përdorura”, sqarojmë se sugjerimi i mor parasysh dhe referenca ndaj PZP në pikën 5 të nenit u hoq.

20. Në lidhje me komentin mbi Kreun IV, të projektligjit “Rrymat specifike të mbetjeve”, ku rekomandohet rishikimi i tyre në raport me parashikimet e rrymave specifike të mbetjeve që trajtohen në projektligjin “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhues të produkteve që gjenerojnë mbetje”, sqarojmë se projektligji duke qënë ligji kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve përfshin të gjitha rrymat e mbetjeve, përveç atyre të përjashtuara specifikisht dhe përcakton rregullat e përgjithshme të trajtimit të tyre. Ndërsa ligji i PZP përfshin vetëm një numër të caktuar rrymash mbetjesh dhe parashikon rregulla të posaçme për trajtimin e tyre. Është e qartë si nga projektligji ashtu edhe nga ligji i PZP se kur një rrymë mbetjesh i nënshtrohet PZP ajo nuk do t’i nënshtrohet kërkesave të përgjithshme sipas projektligjit kuadër. Megjithatë ligji i PZP dhe rrymat e mbetjeve që përfshihen në të mund të ndryshojë në varësi të rrethanave, prandaj duhet të ruhet rregulli i përgjithshëm i menaxhimit të integruar të mbetjeve sipas projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Heqja nga projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve të rrymave të mbetjeve që aktualisht i nënshtrohen PZP-së mund të krijojë boshkllëk ligjor në të ardhmen, pasi mund të

ndodhë që një rrymë mbetjesh të përjashtohet nga PZP dhe të mos jetë as e përfshirë në projektligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Prandaj, në kushtet kur projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe projektligji i PZP janë tërësisht të harmonizuara dhe nuk kanë mbivendosje, nuk është e nevojshme të bëhet ndryshim i sugjeruar.

21. Për komentin që në nenin 64, në pikën 3, të tij, i cili parashikon se Zona e Menaxhimit të Mbetjeve raporton çdo vit pranë Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, mbi zbatimin e masave të planit zonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve duhet të rishikohet në raport me parashikimet e shkronjës “b”, të nenit 23, të këtij projektligji në kushtet kur, Agjencia Kombëtare e Mjedisit “organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e integruar të mbetjeve”, sqarojmë se: Shkronja (b) e nenit 23, parashikon se AKM “(b) *organizon dhe menaxhon regjistrat e të dhënave për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me nenin 71*”. Pra ky nen duhet lexuar bashkë me Nenin 71, që parashikon: “1. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson të dhënat për krijimin, trajtimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve për personat fizikë dhe juridikë privatë.*”

Ndërsa pika (3) e nenit 64 parashikon një detyrim tërësisht ndryshe që nuk ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave të trajtimit të mbetjeve, por me zbatimin e masave të planit zonal të menaxhimit të mbetjeve. Brenda këtij raportimit sigurisht jepen edhe të dhëna për mbetjet e trajtuara brenda zonës, por qëllimi i raportimit është t’i tregojë AKEM si e ka zbatuar planin e menaxhimit të mbetjeve për zonën e menaxhimit të mbetjeve. Ky detyrim është në harmoni edhe me parashikimin e nenit 22 (b) të projektligjit që parashikon se AKEM “(b) *monitoron zbatimin e planeve dhe programeve për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel qendror dhe vendor*”. Në funksion të qartësisë së dispozitës pika 4 e nenit 64 u bashkua me pikën 1 të tij si dhe u riformulua pika 3, në përputhje dhe me parashikimet e nenit 71 të projektligjit. Për sa më sipër, vlerësojmë se parashikimet e sipërcituara nuk krijojnë mbivendosje me njëra-tjetrën.

22. Për komentin që në pikën 5, të nenit 70, të projektligjit, të shmanget përdorimi i lidhëzës “ose”, në përputhje me nenin 28, të Udhëzimit nr.6/2022 të Ministrit të Drejtësisë, sugjerim i cili të mbahet në konsideratë për të gjithë përmbajtjen e projektaktit, sqarojmë se u riformuluan pikat 3 dhe 5 të nenit 70 dhe u reflektua komenti.

23. Në lidhje me komentin që në nenin 71, të projektligjit, të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 23, të këtij projektligji në raport me të dhënat dhe raportimet e bëra në kuadër të raportit që do të nxirret sa i takon të gjithë

procesit të menaxhimit të integruar të mbetjeve me proceset përkatëse për krijimin, trajtimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve për personat fizikë dhe juridik, sqarojmë se neni 71 është rishikuar në funksion të qartësimit dhe ndarjes së kompetencave dhe specifikisht pika 3 dhe 4 parashikojnë detyra të qarta për AKM dhe AKEM në funksion të raportimeve.

24. Në lidhje me komentin 24 të MD, i cili përmbledh një sërë komentesh të ndryshme, ato janë shqyrtuar secili më vete si më poshtë:

- i. Në lidhje me komentin se projektligji lë pa rregulluar çështje thelbësore të trajtimit të integruar të mbetjeve, gjë që konfirmohet edhe nga përmbajtja e nenit 81, i cili ngarkon Këshillin e Ministrave me nxjerrjen e një sërë vendimesh sqarojmë se: Projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve është ligj kuadër. Si i tillë ai përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme të menaxhimit të integruar të mbetjeve ndërsa aktet nën ligjore përcaktojnë specifikimet teknike të proceseve të trajtimit.. Për sektorë të ndryshëm që përmbajnë rregulla të hollësishme teknike këto të fundit miratohen jo me ligj, as me VKM por me udhëzim. Si rrjedhojë miratimi me VKM procedurave dhe specifikimeve teknike të parashikuara në projektligj nuk bien ndesh me teknikën legjislative dhe as me praktikën e ndjekur në Shqipëri.
- ii. Në lidhje me komentin se shumë dispozita të projektligjit kanë karakter deklarativ, si p.sh neni 30, i cili nuk parashikon organin, i cili do të ngrejë impiantet, sqarojmë se ligji është rishikuar dhe njëherë në funksion të rregullimit të dispozitave me karakter deklarativ dhe zëvendësimin e tyre me dispozita të qarta.
- iii. Në lidhje me komentin se mungon një analizë e kostove, të cilat lindin nga trajtimi i menaxhuar i mbetjeve dhe se projektligji ngarkon me përgjegjësi njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa pasur të qartë kostot dhe aftësitë e këtyre njësive për të trajtuar mbetjet në këtë formë, sqarojmë se analiza e kostove është vendosur tek raporti i vlerësimit të ndikimit (RIA), të miratuar nga Departmenti i RIA-s dhe të cilin e gjeni bashkëlidhur praktikës në sistem.
- iv. Në lidhje me komentin se projektligji përmban 64 kundërvajtje administrative, disa prej të cilave dënohen me gjoba deri në 20 milion lekë dhe se të ardhurat nga këto gjoba duhet të derdhen në buxhetin e shtetit dhe jo siç është parashikuar në nenin 79 të projektligjit, sqarojmë se neni 79 është ndryshuar sipas sugjerimit dhe gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.
- v. Në lidhje me komentin se vendimi i gjobës deri në 20 milion lekë nuk ka arsye të bëhet titull ekzekutiv pa pritur vendimmarrjen e gjykatës dhe se afati i pagimit të gjobës prej 10 ditësh vlerësohet shumë i shkurtër, sqarojmë se

parashikimet e kësaj dispozita janë në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 70/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar” ku gjoba është parashikuar titull ekzekutiv dhe afati 10 ditor është në harmonizim me parashikimet e ligjit për kundravajtjet administrative.

- vi. Në lidhje me komentin se neni 83 i projektligjit duhet të përmbajë konkretisht të gjitha aktet, të cilat shfuqizohen sqarojmë se aktet që shfuqizohen janë parashikuar të gjitha tek neni 83.
 - vii. Në lidhje me komentin se aktet e përmendura në nenin 82 bien në kundërshtim me përmbajtjen e projektligjit sqarojmë se vendimet e Këshillit të Ministrave që janë në fuqi do të vazhdojnë të kenë efekte juridike deri në momentin e nxjerrjes së akteve nënligjore sipas parashikimeve të ligjit. Ky sugjerim u mor në konsideratë dhe u fjalua hyrëse e nenit 82 u riformulua.
25. Në lidhje me komentin se sipas nenit 30, të udhëzimit nr.6, datë 24.09.2022“Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”, të Ministrit të Drejtësisë, të shmanget përdorimi i foljeve modale, sqarojmë se *se u rfelektua ky koment duke hequr në gjithë tekstin e projektligjit foljet modale aty ku ishte e mundur duke mos cënuar kuptimin e dispozitës.*
26. Në lidhje me komentin se përmbajtja e relacionit shpjegues të rishikohet dhe të përpunohet tërësisht, duke përfshirë argumente të plota, të qarta dhe konkrete në mbështetje të propozimeve në këtë projektligj, sqarojmë se relacioni i projektligjit është ripunuar për të pasqyruar ndryshimet e fundit.

Ministria e Financave (MF) u shpreh me komente si vijon:

1. Për komentin 1 dhe komentin 14, që lidhen me sqarime shtesë në relacionin shoqërues mbi kostot financiare në buxhetin e shtetit dhe për pushtetin vendor, sqarojmë se ligji ekzistues në fuqi nr. 10 463, datë 22.9.2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, i ndryshuar parashikon në nenin 18, pika 3, dispozitën për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve nga bashkitë të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq. Projektligji propozon grumbullimin e diferencuar edhe për mbetjet bio, në vijim të ndryshimeve të Direktivës Kuadër për Mbetjet. Impakti financiar i këtyre dispozitave sqarohet më poshtë.

Impakti financiar për bashkitë:

- 1. Investime në infrastrukturën e grumbullimit të diferencuar: Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve kërkon investime në kosha dhe mbështetje infrastrukturore për trajtimin e mbetjeve.
- 2. Zonat e Mbetjeve: Çdo bashki është pjesë e një zone mbetjesh, e cila ofron infrastrukturën e nevojshme për trajtimin e mbetjeve.

3. Krijimi i qendrave të kompostimit: Ligji i ri propozon grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme dhe të mbetjeve organike dhe krijimin e qendrave të kompostimit në nivel bashkiak. Mbetjet organike përbëjnë rreth 52% të mbetjeve në Shqipëri, dhe ngritja e qendrave të kompostimit kërkon investime që mund të variojnë nga 50,000 deri në 100,000 euro. Këto investime janë të përballueshme për shumicën e bashkive në Shqipëri.
4. Tarifa e shërbimit të pastrimit: Sipas ligjit për Financat Vendore, kostot e shërbimeve të ofruara nga bashkitë (përfshirë koston e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve) duhet të mbulohen nga tarifa e shërbimit. Aktualisht, tarifa është rreth 0.2% e të ardhurave familjare, ndërkohë që në Bashkimin Evropian kjo tarifë arrin deri në 1%. Për këtë arsye, është e domosdoshme që tarifa e pastrimit të rritet çdo vit, me qëllim përmirësimin dhe afrimin me standardet e BE.

Detaje më të hollësishme lidhur me impaktin financiar, kostot, burimin e të ardhurave dhe aktivitetet përkatëse, janë të detajuara në raportin e vlerësimit të impaktit (RIA) që është hartuar për projektligjin e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

2. Në lidhje me komentin nr. 2 mbi objektivat që parashikohen në nenin 13 të projektligjit dhe që mund të sjellin efekte financiare shtesë për njësitë vendore, sqarojmë se neni 13 i projektligjit është rishikuar duke hequr objektivat specifike të cilat do të përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Ndërsa analiza e hollësishme e kostove është pasqyruar në raportin e vlerësimit të impaktit që shoqëron projektligjin.

3. Në lidhje me komentin për nenin 15 të projektligjit ku përcaktohet se: "Bashkitë, janë përgjegjëse për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve të tjera të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji që ndodhen në territorin nën juridiksionin e tyre", ndërkohë nëse do ti referohemi funksioneve që përcaktohen në bazë të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", bashkitë janë përgjegjëse për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake dhe se si rrjedhojë, duhet saktësuar nëse bashkive nëpërmjet këtij projektligji i shtohen apo delegohen funksione shtesë për menaxhimin e integruar të mbetjeve në përputhje edhe me ligjin nr.139/2015, sqarojmë se bashkive nuk i shtohet asnjë funksion i ri dhe se analiza e hollësishme ligjore e kësaj çështjeje jepet në sqarimet e dhëna më sipër për komentin 10, të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu sqarojmë se risia e projektligjit është ristrukturimi në një nen të vetëm i të gjitha përgjegjësisë të bashkive, të cilave i jepet një rëndësi e shtuar duke konsideruar perspektivën e integritetit në BE, si dhe objektivat për ripërdorim dhe riciklim dhe rikuperime të tjera, të cilat i shohin mbetjet si burim të ardhurash.

Funksionet e bashkisë mbeten të njëjta, por projektligji detajon standardin për secilën nga këto procese, në përputhje me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së.

4. Në lidhje me komentet për nenet 23, 49, 70 dhe 75, sqarojmë se AKM në bashkëpunim me AKSHI-n është në procesin e prokurimit dhe ngritjes të një sistemi të ri të menaxhimit të të dhënave të mbetjeve, ku përfshihen dhe regjistrat e përmendura në projektligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe në projektligjin për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit. Vlen të përmendet që projektligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit i detyron kompanitë të cilat gjenerojnë mbetje të paguajnë kostot për administrimin e këtyre regjistrave (*Neni 6, pika 6/dh e Projektligjit për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit*). Gjithashtu për të mbështetur bashkitë në menaxhimin e mbetjeve, do të zbatohet ligji i posaçëm për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit, ku sipas këtij ligji, kostot për trajtimin e rrymave specifike të mbetjeve, si ato nga ambalazhet, bateritë, pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe automjetet në fund të jetës, do të përballohen nga subjektet që i gjenerojnë këto mbetje. Përgjegjësia e subjekteve prodhuese përfshin tre komponentë kryesorë:

- i. Fushata ndërgjegjësuere për menaxhimin e mbetjeve (ndarjen e mbetjeve në burim, reduktimi i krijimit të mbetjeve etj).
- ii. Parandalimi i krijimit të mbetjeve: Kjo do të realizohet përmes ripërdorimit dhe minimizimit të mbetjeve që krijohen.
- iii. Riciklimi dhe rikuperimi: Bizneset duhet të sigurojnë procese për riciklimin dhe rikuperimin e materialeve nga mbetjet e krijuara, duke kontribuar në ekonominë qarkulluese.

5. Lidhur me komentin për nenin 24 të projektligjit sipas të cilit ngritja e strukturave përgjegjëse për mbetjet duhet të analizohet në këndvështrimin buxhetor sepse mund të shoqërohet me kosto financiare shtesë për buxhetin vendorgjithashtu, edhe në seksionin V përcaktohet ngritja e sistemit të grumbullimit të mbetjeve nga bashkitë, i cili shoqërohet me kosto shtesë për pushtetin vendor, sqarojmë se: kërkesat e nenit 24 të këtij projektligji nuk janë kërkesa të reja. Këto kërkesa ekzistojnë prej 14 vitesh, që me miratimin e parë të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Pra, detyrimi i bashkive për të ngritur sistemin e grumbullimit të mbetjeve nga bashkitë, ekziston dhe është në fuqi të paktën që prej vitit 2011 (detyrimi i bashkive për menaxhimin e mbetjeve bashkiake ka ekzistuar që në vitin 1996 nëpërmjet ligjit nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”).

6. Lidhur me komentin për nenin 29, “Fondi i ekonomisë së mbetjeve”, i cili bie ndesh me nenin 7 të ligjit nr.9936/2008 sipas të cilit “Fondi special i njësive të

qeverisjes qendrore ose vendore krijohet me ligj të veçantë, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, me nismën e ministrit përgjegjës për financat” sqarojmë se neni 29 është rishikuar në funksion të përputhshmërisë me ligjin nr.9936/2008 dhe është përcaktuar gjithashtu që gjobat derdhen në buxhetin e shtetit.

Mekanizmi Financiar në formën e një fondi special, është parashikuar për të mbështetur financiarisht projektet e Njësive të Qeverisjes Vendore dhe/ose të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve. Mbështetja financiare do të jetë në formën e granteve.

Kjo mbështetje financiare, do të jetë mbështetje shtesë dhe nuk ka për qëllim të zëvendësojë mekanizmin financiar aktual të transfertës së pakushtëzuar që përdoret për menaxhimin e mbetjeve (ligji nr. 115/2024 Për Buxhetin e Vitit 2025, neni 15 pika 10). Qëllimi i këtij fondi, do të jetë mbështetja e projekteve konkurruese të investimit në infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve si qendra kompostimi, stacione transferimi, blerje makineri dhe pajisje në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Përzgjedhja e projekteve konkurruese do të shërbejë edhe për ngritjen e kapaciteteve të NJQV për të përthithur fonde nga donatorë të tjerë vendas dhe të huaj, duke qenë me proaktivë, për ti dhënë zgjidhje çështjeve të menaxhimit të mbetjeve në territorin e tyre.

Fondi mund të mbështesi me grante jo vetëm mbi bazën e projekteve konkurruese, por edhe mbi bazën e politikës së rritjes së standartit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, në bashki me të ardhura të ulëta, në zona të mbrojtura apo në zona me rëndësi të veçantë. Ministria përgjegjëse për mjedisin, nëpërmjet AKEM duhet të analizojë nevojat reale dhe kapacitetet financiare të bashkive dhe të bëjë një rankim të ndërhyrjeve prioritare.

Ky fond nuk mund të përdoret për të mbuluar shpenzimet operative për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Burimet financiare të këtij fondi special do të jenë; buxheti i shtetit dhe/ose donatorë vendas dhe të huaj. Në burimet financiare të Fondit, nuk përfshihen të ardhurat e bashkive nga tarifat apo taksat vendore dhe as transferta e pakushtëzuar.

Me qëllim që të kemi një menaxhim eficient dhe efektiv të fondeve publike por edhe të fondeve të donatoreve të huaj, menyra e funksionimit të Fondit, kriteret e vlerësimit të projekteve, shuma maksimale e granteve, publikimi i thirrjeve të hapura, raportimet e nevojshme, procedura e monitorimit të granteve do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pa cënuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për Prokurimet publike si edhe kërkesat për Menaxhimin e Investimeve Publike.

Fondet e buxhetit të shtetit do të menaxhohen duke mbajtur parasysh ligjin organik të buxhetit nr. 9936/2008, i ndryshuar, ndërsa fondet e donatorëve sipas udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024.

7. Në lidhje me komentin nr. 9 për nenin 52 të projektligjit, sqarojmë se rregullimet financiare të përmendura në këtë nen kanë të bëjnë me detyrimet financiare të prodhuesve të baterive dhe të mbetjeve të tyre, që rrjedhin nga ligji i PZP. Si rrjedhojë, nuk ka kosto për buxhetin e shtetit apo për bashkitë, pasi kostot për menaxhimin e baterive dhe të mbetjeve të tyre, përballohen nga subjekti prodhues i baterive dhe mbetjeve të tyre, ose nëpërmjet SHPZP kur këto subjekte prodhuese anëtarësohen aty.

8. Lidhur me komentin se nenet 62 dhe 63 duhet të hiqen duke qënë se përmbajtja e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve dhe përbërja e grupeve ndërinstitucionale të tyre nuk janë objekt i këtij ligji sqarojmë se përfshirja e këtyre dy dokumentave strategjikë është bërë në bazë të Direktivës Kuadër për Mbetjet, e cila ndjek të njëjtën logjikë. Kërkesat për miratimin dhe përmbajtjen e këtyre dokumentave strategjikë duhet të vendosen në ligj për të siguruar të njëjtin standard me BE-në.

9. Lidhur me komentin për nenin 69 “Inspektimi” sipas të cilit shtohen funksione/detyra për strukturën përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, përveç kompetencave të parashikuara në ligjin e posaçëm që rregullon inspektimin në Republikën e Shqipërisë, dhe se këto detyra të shtuara do të shoqërohen me shtim stafi, me kosto shtesë, dhe në rast se po, të përcaktohet burimi i financimit sqarojmë se të gjitha kostot që lidhen me projektligjin janë të parashikuara në raportin e vlerësimit të ndikimit, që është dokument shoqërues i këtij ligji.

10. Në lidhje me komentin nr. 13, sipas të cilit në relacionin shoqërues nuk del qartë nëse shtesat dhe ndryshimet e propozuara janë konsultuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore sqarojmë se projektligji është konsultuar me njësitë e qeverisjes vendore në disa tryeza të posaçme konsultimi.

Lidhur me komentet **për nenet 25, 27 dhe 30 dhe 33** shprehemi si më poshtë:
Neni 25 “Zonat e menaxhimit të mbetjeve”, përcakton krijim impiantesh dhe infrastrukturës mbështetëse për trajtimin e mbetjeve, në këto kushte kërkojmë të sqarohet sa është kosto e ngritjes dhe funksionimit të impianteve dhe infrastrukturës mbështetëse, si dhe cili është burimi i financimit.

Neni 27 “Kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, pika 5 përcakton “Investimet për ndërtimin e objekteve dhe impianteve për trajtimin e mbetjeve bashkiake, jo të rrezikshme dhe të rrezikshme, si dhe shpenzimet për pastrimin

dhe rehabilitimin e vendeve ekzistuese të ndotura me mbetje, përballohen nga Buxheti i Shtetit i Republikës së Shqipërisë, buxhetet e bashkive si edhe burime të tjera të ligjshme me Lidhur me këtë përcaktim, kërkojmë të ndahet kosto për secilin pushtet dhe të paraqitet se ku janë planifikuar këto fonde sipas PBA 2025-2027.

Neni 30 “Rrjeti i integruar i impianteve të trajtimit të mbetjeve”, përcakton se ngrihet rrjeti i integruar i impianteve për rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve në nivel ndërvendor. Lidhur me sa më sipër, kërkojmë të sqarohet se cili është struktura/institucioni përgjegjës për ngritjen e këtij rrjeti, cila është kosto për krijimin e tij dhe si do të akomodohet kjo kosto në tavanet e miratuara. Gjithashtu, të sqarohet së çfarë nënkupton termi “ndërvendor”, i cili përsëritet edhe në pikën 8 të nenit 34, duke lënë përsëri të paqartë se cdo të thotë krijimi i lëndfilleve në nivel ndërvendor.

Neni 33 “Stacionet e transferimit”, përcakton krijimin e këtyre strukturave të palëvizshme ose të lëvizshme të cilat ngrihen me qëllimin e reduktimit të kostove të transportit të mbetjeve, nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, drejt impiantit të rikuperimit apo asgjësimit përfundimtar. Këto struktura janë një risi për projektligjin e propozuar në krahasim me ligjin ekzistues. Si rrjedhim, kërkojmë që të sqarohet sa stacione është menduar të ngrihen, sa do të jetë kosto për ngritjen e tyre, cili/cilët janë institucionet përgjegjëse për ngritjen e këtyre stacioneve si dhe burimi i financimit i ndarë sipas viteve.

Së fundi, në mungesë të paraqitjes së RIA-s, kërkojmë që në relacionin shoqërues, në raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve të paraqitet një analizë e të ardhurave dhe kostove që përcjell ky projektligj, për të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e tij shoqëruar nga burimi i financimit.

Për sa më sipër, sqarojmë se:

Zonat e menaxhimit të mbetjeve dhe infrastruktura e tyre janë të detajuara në Planin Kombëtar Sektorial Për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, miratuar në vitin 2020 nëpërmjet VKM-së nr. 01, datë 13.01.2020 “për miratimin e planit kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta”. Përfshirja e zonave të menaxhimit të mbetjeve në projektligj është bërë për të harmonizuar dokumentin strategjik me legjislacionin respektiv dhe atë europian, ku rrjedhojë, janë shtuar kërkesat jo vetëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, por edhe për zbatimin efektiv të tij. Edhe pse ndarja e mbetjeve në burim dhe grumbullimi i diferencuar janë kërkesa të Ligjit ekzistues në fuqi nr. 10493 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", aktualisht niveli i zbatimit është ende i ulët, duke u realizuar vetëm në disa bashki përmes projekteve pilot.

Iniciativa e re e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që ka si objektiv përafrimin e legjislacionit dhe zbatimit të tij, do të sjellë një barrë të konsiderueshme financiare për bashkitë. Për të lehtësuar këtë kalim në ekonominë qarkulluese dhe për t'u dhënë mundësi bashkive që të rrisin gradualisht tarifat e pastrimit, Ministria e Mjedisit është duke punuar për të ofruar mbështetje financiare përmes donatorëve të huaj dhe linjave të kredive. Kjo mbështetje është e fokusuar kryesisht në zonat e menaxhimit të mbetjeve.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, me mbështetje nga KfE, Zona e Menaxhimit të Mbetjeve të Korçës dhe Pogradecit është e kompletuar me infrastrukturën e nevojshme, ndërsa janë në proces përfundimi edhe 5 zona të tjera. Po ashtu, me mbështetje nga AFD, do të plotësohet infrastruktura e zonës së Kukësit dhe Gjirokastrës. Me mbështetje nga GIZ, do të ndërtohen qendra kompostimi në 15 bashki, dhe gjithashtu, një qendër multifunkionale (civic amenity center) do të ndërtohet në Lezhë. Këto investime janë pjesë e një plani më të gjerë për përmirësimin e infrastrukturës dhe menaxhimin e mbetjeve në vend.

Një pasqyrë e financimeve nga Donatorët e huaj dhe linja kredish, jepet në tabelën e mëposhtme:

FINANCIMI I HUAJ kapitulli 02 Grante/Kredi					
	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027		
Programe për Mbrojtjen e Mjedisit (Financim I Huaj)	390,000,000	390,000,000	390,000,000	Vlera e plote e projektit në leke	Vlera për kohezgjatjen e projektit
Sistemi i mgritur për parandalimin e mbetjeve detare (mbaron në 2025)	30,000,000			65,700,000	32,850,000
Ekonomia qarkulluese IPA 3 (Agjencia Franceze për Zhvillim/AFD)	60,000,000	60,000,000	50,000,000	2,080,500,000	520,125,000
Raportet performante të hartuara (Projekti SANE - SIDA) (mbaron në shkurt 2026)	30,000,000	10,000,000		8 Mil Sek	
BE për natyrën (UNDP)	30,000,000	40,000,000	50,000,000	657,000,000	219,000,000
Be për Ekonominë Qarkulluese dhe Ekonomia qarkulluese për zhvillimin e qendrueshëm urban në Shqipëri (GIZ)	50,000,000	50,000,000	40,000,000	1,872,450,000	624,150,000
Mbështetje për programin e mjedisit (SIDA)	30,000,000	30,000,000	40,000,000	219,000,000	73,000,000
Sa Creativity	20,000,000	20,000,000	10,000,000		
SameSEA (Projekti i sapomiratur IPA)	8,000,000	3,000,000			
Clean and Resilient Environment for Blue Sea Project CARE4BLUESEA (KREDI)	132,000,000	177,000,000	200,000,000	2,028,000,000	338,000,000
Menaxhim i Mbetjeve Urbane (Financim I Huaj)	200,000,000	200,000,000	200,000,000		
Fond i Ngrire	200,000,000	200,000,000	200,000,000		

Programi Mbrojtja e Mjedisit					
Emertimi Programit	Kapitulli	Totali i shpenzimeve kapitale	PBA 2025-2027		
			Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
Mjedisi			90,000,000	90,000,000	90,000,000
AKM-Pajisje TIK	K.1 (Fin.Brendsh)		2,000,000	2,000,000	2,000,000
Raporte performance te hartuara(Sane Sida mbarone 2026)	K.4 (TVSH)		3,000,000	2,000,000	-
Sistem I ngritur per Parandalimin e Mbetjeve Detare (Marin Litter)	K.4 (TVSH)		6,125,000		-
IPA-Ekonomia Qarkulluese - Aparat(Agjencia Franceze per Zhvillim)	K.3 (K.L)		54,045,000	76,700,000	78,700,000
Tvsh-Prespa - AKZM	K.4 (TVSH)		8,030,000		
Ndarja ne burim mbetjeve shtepiake - bashkia Berat	K.4 (TVSH)		7,000,000		
Sa Creativity	K3 (K.L)		800,000	800,000	800,000
SameSEA (Projekti I sapomiratur IPA)	K3 (K.L)		1,000,000	500,000	500,000
Mbeshtetje per programin e mjedisit (esp-SIDA)	K4 (TVSH)		8,000,000	8,000,000	8,000,000

Parashikimet financiare për implikimet e projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve janë të detajuara në dokumentin përkatës të RIA-s, që do të gjeni bashkëlidhur këtij relacioni. Këto parashikime janë bërë sipas këtyre supozimeve kryesore:

- Periudha e planifikimit të projeksioneve financiare është 2025 – 2035.
- Vlerësimet e kostove janë përgatitur veçmas për zonat e ndryshme të menaxhimit të mbetjeve dhe operacionet e menaxhimit të mbetjeve, dhe më pas janë llogaritur për të gjithë vendin. Vlerësimet e kostove janë përgatitur me çmimet aktuale (2024) dhe janë paraqitur në Lekë shqiptare me kursin e këmbimit prej 98.0 Lekë për 1 EUR.
- Kostot vjetore llogariten si shumator i amortizimit dhe kostove operative për vitin përkatës.
- Vlerat aktuale (PV) të kostove të investimit, kostove operative dhe të ardhurave llogariten duke përdorur një normë diskontimi prej 5%.
- Kostot e njësisë së zbritur për ton mbetjesh të gjeneruara gjatë periudhës së planifikimit llogariten duke pjesëtuar PV e kostove me PV e mbetjeve.

- Kostot e financimit përfshijnë normat e interesit për kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFI), duke supozuar një normë interesi prej 3%.
- Kostot në fillim të periudhës së planifikimit janë pranuar sipas të dhënave të INSTAT: Në vitin 2023, Shqipëria mbledhi rreth 835,000 tonë mbetje, me një mesatare gjenerimi për frymë prej 348 kg në vit. Në nivel kombëtar, rezulton se 68% e kostove të menaxhimit të mbetjeve mbulohen nga tarifat e shërbimit, ku kostoja mesatare për mbledhjen e 1 toni mbetjesh në Shqipëri është rreth 8,830 lekë. Në nivel kombëtar, madhësia mesatare e një familjeje është 3.7 persona për familje. Në vitin 2023, vetëm gjashtë bashki arritën të mbulojnë plotësisht kostot e tyre përmes tarifave: Berati, Mati, Devolli, Bulqiza, Lushnja dhe Kuçova.
- Pjesa e mbetjeve shtëpiake u pranua të jetë 80% e të gjitha mbetjeve bashkiake, ndërsa subjektet juridike kontribuojnë me 20%. I njëjti përqindje shpërndarjeje e të ardhurave nga tarifat e menaxhimit të mbetjeve është supozuar për vitin 2025.
- Sipas të dhënave të INSTAT, vlera mesatare e të ardhurave neto familjare është pranuar të jetë 961,379 Lekë (80,115 Lekë në muaj).
- Të ardhurat familjare supozohen të rriten me 3% në vit gjatë periudhës së planifikimit.
- Pragu i përballueshmërisë për tarifat e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve u pranua të jetë i barabartë me 1% të të ardhurave të disponueshme familjare.
- Tarifat për familjet parashikohen të rriten me 7% në vit dhe të arrijnë në 3,464.43 Lekë/përsone/vit në vitin 2035.
- Tarifat për subjektet juridike parashikohen të rriten me 10% në vit derisa të arrihet mbulimi i plotë i kostove.
- Transferimet nga buxhetet bashkiake parashikohen në të njëjtin nivel nominal si në vitin 2025.
- Skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesve do të jenë përgjegjëse për financimin e kostove të investimit dhe operimit për mbledhjen e ndarë dhe seleksionimin e mbetjeve të riciklueshme.
- Tarifat e mbetjeve bashkiake dhe transferimet nga buxhetet bashkiake supozohet të mbulojnë kostot vjetore për të gjitha shërbimet e tjera të menaxhimit të mbetjeve.
- 75% e kostove të investimit për ndërtimin e impianteve të kompostimit, digestimit anaerobik dhe trajtimit mekaniko-biologjik pas vitit 2028 supozohet të financohen me grante të BE-së.

Lidhur me kostot që rrjedhin nga zbatimi i këtij projektligji, sipas përlllogaritjeve të bëra, rezulton se kostot e investimeve deri në vitin 2036, janë 67 miliardë lekë.

Burimi i financimit për mbulimin e këtyre kostove, do të jetë:

- 10 miliardë lekë nga skema e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit
- 12.8 miliardë lekë nga financimet e sektorit privat, si prodhimi i RDF-së, kontrata të tjera shërbimi etj
- 44 miliardë lekë do të jenë financime publike, nga të cilat:
 - rreth 8 miliardë lekë merren nga tarifat e bashkive;
 - 22 miliardë lekë nga grante nga Bashkimi Evropian; dhe
 - rreth 14.7 miliardë lekë mund të përballohen me kredi nga institucionet ndërkombëtare financiare (përlllogaritur me një interes 3% në vit)

Kostot operative janë të përlllogaritura në nivelin nga 6.5 miliardë lekë në vitin 2025 deri në 10 miliardë lekë në vitin 2035.

Zërat kryesorë të kostove operative janë:

- Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve, nga 720 milionë lekë në vitin 2027 (viti i parashikuar për fillimin e grumbullimit të diferencuar) deri në 1.8 miliardë lekë në 2035.
- Grumbullimi i mbetjeve bashkiake të përziera, nga 334 milionë lekë në 2 miliardë lekë.
- Kompostimi i mbetjeve bio, nga 370 milionë lekë deri në 890 milionë lekë.
- Përzgjedhja e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar, nga 465 milionë lekë në 761 milionë lekë.
- Trajtimi i tepricave të mbetjeve të përziera, nga 911 milionë lekë në vitin 2031 në 1.8 miliardë lekë deri në 2035.
- Tretja anaerobe e mbetjeve ushqimore, nga 628 milionë lekë në 2031 deri në 1.4 miliardë lekë në 2035.
- Prodhimi i RDF-së dhe llojeve të tjera të energjisë nga mbetje, nga 669 milionë lekë në vitin 2031 në 704 milionë lekë në vitin 2035.
- Lendfilli, nga 270 milionë lekë në vitin 2026 në 739 milionë lekë në vitin 2031.

Burimi i financimit për mbulimin e kostove operative, do të jetë:

Mbulimi i kostove operative do të bëhet nga skema e PZP-së dhe nga financimi i bashkive (që merret nga tarifat e pastrimit dhe të ardhura të tjera), në raportin 17% dhe 83% respektivisht në vitin 2026, dhe duke mbërritur në raportin 24% me 76% respektivisht në vitin 2035.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

1. Në lidhje me sugjerimin që të ndryshohet përkufizimi i termit “Mbetje spitalore” në nenin 4 pika 34 (ish pika 36), sqarojmë se sugjerimi është pranuar dhe ndryshimi i përkufizimit është bërë sipas sugjerimit të MShMS.
2. Në lidhje me komentin mbi shkronjat “ç” dhe “c” të nenit 35 “Mbetjet dhe trajtimet e përjashtuara nga lëndfillet”, sqarojmë se ky nen është ndryshuar duke pasqyruar sugjerimet e MShMS duke u riformuluar pika “ç” Pikat c dhe ç nuk mund tëë bashkohen pasi mbetjet e substancave kimike nuk i përkasin vetëm mbetjeve spitalore.. Në lidhje me komentin se duhet të përcaktohet qartë në ligj grupimi i mbetjeve spitalore të parrezikshme, nëse ky grupim nuk është parashikim i pikës 27 të nenit 4 “Përkufizime”, si dhe pranimi i tyre në lëndfill, nëse nuk është parashikim i shkronjës ‘b’ të pikës 5 të nenit 34 “Lëndfilli”, sqarohet se Neni 4 (27) e përcakton qartë se konsiderohen mbetje të pa rrezikshme të gjitha mbetjet që nuk kanë vetitë e rrezikshme të parashikuara në shtojcë. Nuk mund të parashikohet një listë e plotë me mbetje spitalore të pa rrezikshme pasi kjo varet nga vetitë e mbetjeve. Kjo do të përcaktohet në përputhje me dokumentacionin shoqërues të mbetjeve dhe me procedurat e pranimi në lëndfill. Nga ana ligjore është e qartë se sipas nenit 34 pika (5) shkronja (b) e projektligjit, çdo mbetje e çdo lloj origjine, d.m.th përfshirë mbetjet spitalore, do të pranohet në lëndfillin e mbetjeve jo të rrezikshme nëse nuk ka veti të rrezikshme.
3. Në lidhje me komentin për nenin 55 “Mbetjet spitalore” sqarohet se është marrë në konsideratë.
4. Në lidhje me komentin se duhet të ndryshohet pika 3 e nenit 69 “Inspektimi” sqarohet se është marrë në konsideratë dhe është riformuluar pika 4 e nenit 69.

Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural (MBZHR) ka paraqitur komentet e mëposhtme në lidhje me projektligjin:

1. Në lidhje me komentin për nenin 4, pika 4 dhe nenin 14, pika 1 dhe pika 2 termi “operacion” të zëvendësohet me termin “proces”, sqarojmë se nga ana teknike termi operacion nuk duhet të zëvendësohet nga termi ‘proces’ sepse p.sh operacioni i asgjësimit nuk është një proces i vetëm por përfshin një sërë procesesh prandaj termi proces nga ana teknike është kufizues.
2. Në lidhje me komentin se neni 15, shkronja b, togfjalëshi “*prodhuesi i produktit*” të zëvendësohet me togfjalëshin “*subjekti prodhues*” është reflektuar duke u riformuluar pika 1 e nenit.
3. Në lidhje me komentin që në nenin 17, pika 1, termi “personat” të zëvendësohet me termin “subjektet”, sqarojmë se u reflektua duke u riformuluar pika 1 e këtij neni.

4. Në lidhje me komentën që në nenin 56 fjalë “*Menaxhimi i mbetjeve të nënprodukteve shtazore kryhet në përputhje me parimet e këtij ligji dhe me kushtet, kriteret, procedurat dhe standardet e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm*” të zëvendësohet me paragrafin “*Landfillet, inceneratorët/djegës për eliminimin përfundimtar të nënprodukteve me origjinë shtazore, koo-inceneratorët për prodhimin e energjisë dhe impiantet për prodhimin e biogazit i nënshtrohen parimeve të këtij ligji. Kërkesat teknike të landfilleve, inceneratorëve, koo-inceneratorëve, impianteve të prodhimit të biogazit dhe kushtet specifike të nënprodukteve që eliminohen në landfill dhe inceneratorë ose përdoren në koo-inceneratorë për prodhimin e energjisë ose në impiante për prodhimin e biogazit, i nënshtrohen legjislacionit të posaçëm për nënproduktet me origjinë shtazore.*”, sqarojmë se zëvendësimi i kërkuar nuk mund të bëhet pasi riformulimi i paragrafit të parë është i panevojshëm sepse të gjitha termet përfshihen tek varianti ekzistues. Konkretisht termet ‘*Landfillet, inceneratorët/djegës për eliminimin përfundimtar të nënprodukteve me origjinë shtazore*’ përmbledhet nga termi ‘menaxhim i mbetjeve të nënprodukteve shtazore’ i përdorur në nenin 56 të projektligjit. Kjo sepse, sipas përkufizimeve të projektligjit të mbetjeve ‘menaxhimi i mbetjeve’ përfshin një sërë operacionesh si landfillimi, incinerimi, asgjësimi etj. Kështu teknika e duhur legjislative është që të mos ketë ripërsëritje ose përsëritje të tejzgjatura të koncepteve që janë të përkufizuara në ligj. Qëllimi i përkufizimit është pikërisht shmangia e këtyre përsëritjeve. Edhe riformulimi i paragrafit të dytë nuk është i nevojshëm. Konkretisht pjesa e parë e paragrafit që ripërsërit operacionet e menaxhimit nuk ka nevojë të jetë pasi mbulohet nga termi menaxhimi i mbetjeve siç u sqarua. Pjesa e fundit e paragrafi ‘*i nënshtrohen legjislacionit të posaçëm për nënproduktet me origjinë shtazore*’ mbulohet gjithashtu nga neni 56 i projektligjit që parashikon pikërisht të njëjtën gjë duke thënë se: ... dhe me kushtet, kriteret, procedurat dhe standardet e parashikuara nga legjislacioni i posaçëm. Pra rregullat teknike të menaxhimit të mbetjeve do të miratohen në zbatim të ndërthurur si të ligjit për mbetjet ashtu edhe të legjislacionit për nënproduktet shtazore.

5. Në lidhje me komentën se në nenin 77, pika 37, togfjalëshi “*Menaxhimi i mbetjeve të nënprodukteve shtazore*”, të zëvendësohet me togfjalëshin “*eliminimin ose/përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore*”, sqarojmë se u reflektua duke u riformuluar kjo pikë sipas sugjerimit të MBZHR.

6. Në lidhje me komentën mbi kundërvajtjet administrative, të parashikuara nga neni 45 dhe 47 i projektligjit “për nënproduktet shtazore” është pranuar sugjerimi dhe është reflektuar në projektligj.

7. Në lidhje me komentimin se nënproduktet me origjinë shtazore nuk mund të jenë subjekt i 2 (dy) ligjeve, sqarojmë se ky projektligj nuk ka të bëjë me produktet me origjinë shtazore por vetëm me mbetjet e produkteve me origjinë shtazore. Në ligjin ekzistues në fuqi “për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 36 adresonte nënproduktet shtazore, duke krijuar autorizimin ligjor për një VKM të përbashkët midis ministrit përgjegjës për mjedisin dhe atij përgjegjës për bujqësinë. Me rregullimin e nënprodukteve shtazore nëpërmjet ligjit të posaçëm “për nënproduktet shtazore” të propozuar nga MBZhR, projektligji i ri për menaxhimin e integruar të mbetjeve ka riformuluar dispozitat e nenit 56 në “mbetjet e nënprodukteve shtazore”, pra për të trajtuar vetëm fazën mbetje, të ciklit të jetës së nënprodukteve shtazore.

Ministër i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit është shprehur me komente si vijon:

Në kuadër të bashkërendimit të proceseve të brendshme të institucioneve shtetërore, të hartimit të politikave për lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe të parimeve të reformës të derregullimit, sugjerojmë të vlerësohet mundësia që aplikimi për autorizimin për eksportin dhe transitin e mbetjeve pranë Ministrisë përgjegjëse për mjedisin, të mund të ofrohet përmes shërbimit online nga momenti i krijimit të infrastrukturës të nevojshme teknike.

Për këtë sugjerim sqarojmë se VKM nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, ka pësuar ndryshime me datë 1.8.2024, ku procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i aplikimit dhe tërheqja e autorizimeve për eksportin, transitimin e mbetjeve, si dhe raportimi sipas pikës 24, të këtij vendimi, bëhet në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

Sa i përket sugjerimit që, referuar kreut VII “Inspektimi, kërkesa për mbajtjen e të dhënave dhe raportimit” dhe parashikimeve për inspektimin në përmbajtjen e projektligjit, projektligji të dërgohet për mendim edhe pranë Inspektoratit Qendror, kjo në kuadër të miratimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje edhe me nenin 16, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, ku parashikohet që Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit

dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë duke ofruar mendime për çdo nisme ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit, sqarojmë se sugjerimi u pranua, ku me anë të shkresës nr.212 Prot, datë 09.01.2025, është dërguar për mendim projektligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” së bashku me relacionin shpjegues dhe dokumentacionin shoqërues pranë Inspektoriatit Qendror.

Përsa më sipër **Inspektoriatit Qendror** nuk ka përcjellë asnjë përgjigje.

Ministri i Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin është shprehur pa komente brenda fushës së përgjegjësisë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është shprehur me komentin që në pikën 1, të nenit 37, fjalia e parë të jetë si vijon: “Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, pas marrjes së mendimit nga ministri përgjegjës për energjinë, miraron rregullat për incenerimin e mbetjeve”.

Sqarojmë se ky koment është reflektuar në nenin 37, pika 2 e projektligjit.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është shprehur parimisht pa komente.

Ministër i Shtetit dhe Kryenegociator ka paraqitur komentet si më poshtë vijon:

Vërehet se në tabelat e përputhshmërisë nuk janë paraqitur vetëm ndryshimet në projektligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, por edhe ndryshime në akte të tjera, siç janë:

- ligji nr.10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
- ligji nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
- ligji nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- ligji nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- vendimi nr.538, datë 26.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar;
- ligji nr.91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, i ndryshuar.

Vendosja e këtyre akteve në tabelën e përputhshmërisë, edhe pse në relacionin shoqërues ju shpreheni vetëm në lidhje me përafrimin e synuar për projektligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” krijon konfuzion për projektaktin, që synohet të përafrohet momentalisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”.

Për sa më lart, lutemi për qartësimin se cili prej akteve të mësipërme synon të përafrohet aktualisht me direktivën, si dhe për hartimin e tabelave të përputhshmërisë në të dyja gjuhët, shqip dhe anglisht, vetëm për atë ose ato projektakte, që do të përafrohen me *acquis*-në e Bashkimit Evropian.

Në relacionin shoqërues të projektaktit citohet se projektligji dhe aktet që do të miratohen në zbatim të tij synojnë që të arrijnë një shkallë të lartë përafrimi me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e cila shfuqizon disa direktiva. Bazuar në vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, përcaktimi i shkallës së përputhshmërisë me *acquis*-në është i papërputhur, i pjesshëm ose i plotë.

Ndaj, lutemi për përcaktimin e shkallës së përafrimit, sipas këtyre tri niveleve.

Për sa më sipër, lutemi për reflektimin e komenteve, duke ndjekur rregullat e përcaktuara në vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, si dhe ridërgimin e paketës së projektligjit për vlerësim pranë zyrës së ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator.

Sqarojmë se janë reflektuar komentet nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator në tabelën e përputhshmërisë dhe në relacion.

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor nuk ka përcjellë komente, por është shprehur Këshilli Konsultativ i AMVV dhe Shoqata për Autonomi Vendore si më poshtë:

Këshilli Konsultativ është shprehur me komente.

Theksojmë se në vijim të komenteve të marra nga Ministritë e Linjës, projektligji ka pësuar një sërë ndryshimesh dhe si pasojë, një pjesë e komenteve të Këshillit Konsultativ janë ezauruar në riformulimet që ka pësuar projektligji. Në vijim, jepet argumentimi për komentet e Këshillit Konsultativ të cilat nuk janë reflektuar në projektligj.

1. Ligji duhet të miratojë një standard minimal të qeverisjes vendore për arritjen e objektivave.

Lidhur me komentin e mësipërm sqarojmë se në nenin 13 (Objektivat dhe metodologjia e llogaritjes së përmbushjes së objektivave të përgatitjes për ripërdorim, riciklimit dhe rikuperimeve të tjera të mbetjeve), paragrafi 2 i projektligjit parashikon se me propozim të ministrit të Mjedisit dhe pas

konsultimit me njësitë e qeverisjes vendore, do të miratohet VKM-ja që përcakton “vitin në të cilin fillon detyrimi për përmbushjen e objektivave të ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve, afatet e ndërmjetme si dhe metodologjinë e përlllogaritjes së përmbushjes së objektivave”.

Gjithashtu, bashkitë dhe zonat e menaxhimit të mbetjeve duhet të hartojnë planet vendore dhe ato zonale respektivisht për menaxhimin e integruar të mbetjeve, në përputhje me këtë ligj.

2. Në lidhje me raportimin e të dhënave ligji duhet të saktësojë që operatori të furnizojë bashkitë me këto të dhëna.

Në nenin 71 të projektligjit u reflektua komenti i Këshillit Konsultativ, duke shtuar pikën 3 lidhur me detyrimin e bizneseve për të raportuar pranë bashkive për krijimin, përpunimin, grumbullimin apo trajtimin e mbetjeve. Kjo është harmonizuar edhe me detyrimin e përcaktuar në VKM-në nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin, dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar, Shtojca 4, Seksioni IV, gërma A.

3. Të saktësohet roli i AKEM dhe AKM mbi përgjegjësitë e bashkive për hartimin e të dhënave të mbetjeve.

Sqarojmë se Sipas nenit 71 paragrafi 1 dhe 2 të projektligjit:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson të dhënat për krijimin, trajtimin, ripërdorimin, riciklimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve për personat fizikë dhe juridikë.
- AKEM mban dhe përditëson të dhënat për sasinë e mbetjeve të krijuara dhe të trajtuara nga Bashkitë.

4. Të qartësohet pronësia mbi impiantet fundore të trajtimit të mbetjeve.

Të gjitha mundësitë dhe format e pronësisë janë të hapura ashtu siç ndodh për të gjitha shërbimet e tjera publike. Neni 26 (1) (dh) parashikon se marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor duhet të përcaktojë edhe pronësinë e infrastrukturës. Pronësia nuk rregullohet në ligjin e mbetjeve pasi mënyra sesi rregullohet pronësia është e parashikuar në legjislacione të ndryshme dhe mund të ndryshojë rast pas rasti.

ryshme dhe mund të ndryshojë rast pas rasti.

Sqarojmë se pronësia e impianteve varet nga entiteti që disburson fondet dhe nga marrëdhënia kontraktore:

- a. nëse ndërtohet me fonde të buxhetit të shtetit pronësia do të jetë e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor mund ti jepet në përdorim;
 - b. nëse ndërtohet me fondet e buxheteve të bashkive pjesë e zonës së menaxhimit të mbetjeve, bashkitë do të jenë bashkëpronare sipas përqindjes së fondeve të derdhura ose autoriteti që administron zonën e menaxhimit të mbetjeve mund të jetë pronar, sipas përcaktimeve të marrëveshjes ndërvendore;
 - c. Nëse ndërtohet me formulën PPP do të zbatohen rregullat e kësaj procedure sipas kontratave përkatëse.
5. Kush i vendos gjobat për tarifat vendore dhe për shkeljet e krijuesit të mbetjeve? Sistemi i mbledhjes së tarifave vendore dhe i gjobave / kamatë vonesave për mospagimin e tyre do të vazhdojë të zbatohet pa asnjë ndryshim, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
- Ndërsa gjobat në lidhje me kundërvajtjet administrative që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, përfshirë edhe shkeljet e krijuesit të mbetjeve, vendosen nga inspektoriati, në përputhje me ligjin për inspektimin.

Shoqata për Autonomi Vendore shprehet me komentet si vijon:

Shtohen përgjegjësitë dhe detyrat për NjQV-të/Bashkitë, duke u bërë institucioni me përgjegjësi të plotë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. 1. Projektligji i menaxhimit të integruar të mbetjeve nuk i shton bashkive asnjë funksion të ri. Funksionet e bashkive në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë parashikuar në ligjin 139/2015, në nenin 23 paragrafi 10 që parashikon:

“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.”

Të gjitha dispozitat e projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve që parashikojnë detyrimet e bashkive thjesht zërthejnë funksionet që bashkia ka sipas ligjit 139/2015 më sipër, në detyra më konkrete dhe në hapa më të qarta, por nuk shton asnjë funksion të ri.

a) Kompetencat dhe mbështetja që i duhen dhënë NjQV-ve për ndryshimet e nevojshme të strukturës dhe ngritjes së sistemit MIM duhen parashikuar me kujdes në të gjithë aktet nënligjore, të cilat në konsultim me NjQV-të, duhet të qartësojnë mekanizmat dhe instrumentet për funksionimin e sistemit të MIM, duke parashikuar kohën e nevojshme tranzitore për ngritjen dhe operimin e tij. (Neni 18, Neni 24).

b) Koha e parashikuar në aktet nënligjore për ngritjen e këtij sistemi duhet të marrë në konsideratë specifikat e çdo NjQV-je (në shtesë të specifikime që i parashikon projekt ligji) përfshirë edhe kapacitetet ekzistuese, ecurinë e

deritanishme në trajtimin fundor të mbetjeve, etj. (Neni 12, Pika 3, Neni 13. Pika 2).

Projektligji parashikon shprehimisht që aktet nën ligjore do të hartohen në konsultim me NJQV-të (neni 13 pika 2, neni 35 pika 3).

c) Bashkitë të kenë autoritetin të vetë-përcaktojnë prioritetet për ngritjen e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për rrymat e paraqitura si letra, metalet, plastika, qelqi, mbetjet bio dhe në vijim tekstilet.(Neni 31,pika 5).

Sqarojmë se projektligji nuk u ndërhyr bashkive në kompetencat dhe funksionet që kanë sipas ligjit 139/2015. Brenda parashikimeve të përgjithshme të projektligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, që vendos standardet kombëtare, bashkitë hartojnë planin vendor në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore duke ju përmbajtur afateve dhe objektivave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve. Projektligji parashikon shprehimisht që aktet nën ligjore për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve do të hartohen në konsultim me NJQV-të.d) Projekt ligji duhet të parashikojë funksionimin e sistemit të MIM bazuar në standarde të përcaktuara/unifikuara dhe miratuara pas konsultimit me NjQV-të. Ai duhet të parashikojë hartimin dhe miratimin e standardit minimal të menaxhimit të mbetjeve në nivelin e NjQV-së, i cili garanton arritjen e objektivave të këtij ligji (koncept i parashikuar në SKMIM 2020-2035) (Neni 24, Pika f, Nenet 31-34).

Sqarojmë se projektligji parashikon se për kryerjen e veprimtarive të menaxhimit të mbetjeve do të ndiqen standardet teknike minimale që përcaktohen me VKM. Këto janë standarde kombëtare dhe parashikohen nga disa dispozita të projektligji:

Neni 46 i projektligjit, mbi normat teknike minimale, përcakton se me VKM do të vendosen standardet minimale për të gjitha veprimtaritë e menaxhimit të mbetjeve;

Nene të tjera të projektligjit gjithashtu përcaktojnë se me VKM do të vendosen standardet e posaçme të veprimtarive si psh. lëndfilli.

Gjithashtu projektligji në nenin 31, përcakton edhe parimet / standardet e përgjithshme kombëtare që udhëheqin bashkitë për ngritjen e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, sipas të cilit:

"2. Sistemi bashkiak i grumbullimit të mbetjeve organizohet në mënyrë që:

- a) të garantojë mbulimin e të gjithë territorit nën juridiksion të bashkisë;
- b) të jetë i aksesueshëm nga banorët e territorit nën juridiksionin e bashkisë;
- c) të garantojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore;

ç) të jetë i përshtatshëm duke marrë parasysh numrin e popullsisë, sasinë e mbetjeve të krijuara, veprimtaritë ekonomike dhe zhvillimin e territorit nën juridiksionin e bashkisë.”

Ndërsa rregullat konkrete të menaxhimit në nivel bashkiak, si p.sh metodën e grumbullimit të mbetjeve derë më derë apo me kontejnerë, oraret e grumbullimit, llojin e kontratave me operatorët publikë apo privat, etj., nuk mund të përcaktohen si standarde nga pushteti qendror pasi kjo do të cenonte autonominë vendore që kanë bashkitë sipas ligjit 139/2015. Këto norma / standard konkrete përcaktohen nga vetë bashkitë.

Me miratimin e VKM-ve të përmendura më sipër standardet kombëtare do të jenë të përcaktuara dhe bashkitë në përputhje me to do të miratojnë, ose do të përditësojnë standardet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Organizimi konkret dhe standardet konkrete në kryerjen e punëve të përditshme do të vendosen nga bashkitë sipas territorit dhe nevojave të tyre.

e)Projekt-ligji duhet të përcaktojë autoritetin që kryen monitorimin e zbatimit të masave të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar sektorial, dhe autoritetin që vlerëson përputhshmërinë e Planeve Zonale të Mbetjeve me objektivat e Planit Kombëtar. Projekt ligji duhet të përcaktojë strukturën e dokumentit të Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, dhe/ose rrymave të veçanta të mbetjeve (Nenet 63, 64, 65, 66).

Në lidhje me kërkesën për përcaktimin e autoritetit që monitoron zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar Sektorial, Neni 22 (b) i projektligjit parashikon AKEM si institucion përgjegjës për monitorimin e planeve dhe programeve për menaxhimin e mbetjeve në nivel qendror dhe vendor. Në konceptin e planeve dhe programeve përfshihen strategjia kombëtare dhe Masterplani. Gjithashtu, sipas nenit 21, pika 2, shkronja b, Ministria përgjegjëse për mjedisin monitoron zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare. Në lidhje me kërkesën për përcaktimin e autoritetit që vlerëson përputhshmërinë e Planeve Zonale dhe objektivate të Planit Kombëtar, projektligji nuk parashikon shprehimisht këtë detyrë ngarkuar një institucioni specifik. Ky funksion mund t'i ngarkohet AKEM-it pasi projektligji parashikon aktualisht se zonat e menaxhimit të mbetjeve raportojnë çdo vit pranë AKEM, mbi zbatimin e masave të planit zonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve. (Neni 64 paragrafi 3 i projektligjit).

Në lidhje me kërkesën që projektligji të përcaktojë strukturën e Planit vendor të menaxhimit të mbetjeve dhe / ose rrymave të veçanta të mbetjeve. Projektligji parashikon një sërë planesh dhe programesh në nivel qendror dhe vendor:

- Strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit (neni 62) - Përmbajtja dhe struktura e të cilit është e parashikuar tek Shtojca 4 e projektligjit;
- Planin Kombëtar Sektorial - Masterplanin (neni 63) - Përmbajtja dhe struktura e të cilit nuk është përcaktuar me hollësi, por neni 63 parashikon disa elemente thelbësore që përmban ky plan: analiza sektoriale/territoriale; objektivat e zhvillimit; planin e zhvillimit' përcaktimet territoriale; planin e veprimit; hartat.
- Programi kombëtar për parandalimin e mbetjeve (neni 66): përmbajtja dhe struktura e të cilit nuk janë parashikuar hollësisht por përcaktohen disa elemente të përmbajtjes si psh. objektivat e parandalimit të mbetjeve dhe masat për realizimin e tyre sipas Shtojcës 5 të këtij ligji.
- Planin Zonal, për secilën zonë të menaxhimit të mbetjeve: përmbajtja dhe struktura e të cilit është parashikuar hollësisht në Shtojcën 7 të projektligjit.
- Planin vendor, që është plani për territorin e çdo bashkie: për këto plane nuk përcaktohet ndonjë strukturë specifike, por parashikohet përmbajtja minimale në paragrafin 2 të nenit 65 ku përcaktohet se plani vendor përmban ‘planin për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve, që prodhohen në territorin e vet, përfshirë letrën dhe kartonin, ambalazhet prej qelqi, metalin e plastikën, dhe mbetjet bio ose masën e gjelbër nga parqet a kopshtet e shtëpive’ dhe se në planin vendor ‘mund të parashikohen masa më shtrënguese sesa masat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare’.

Bazuar në analizën e mësipërme nuk është e nevojshme të krijohet ndonjë strukturë të posaçme të planeve / programeve në nivel kombëtar apo në nivel vendor. Përmbajtja e tyre është mjaft e qartë dhe elementet thelbësore janë të përfshira në projektligj.

f) Projekt-ligji duhet të përmbajë a) listën e mbetjeve të rrezikshme bashkiake dhe b) parashikimet për detyrimet që lindin për NjQV-të për menaxhimin e rrymave të tjera të mbetjeve: si mbetjet e rrezikshme, elektronike, makinat në fund të jetës që grumbullohen në territorin e bashkisë. Ndonëse trajtimi fundor i tyre parashikohet të ndodhë në qendra për trajtim të specializuar në nivel zonal apo kombëtar, duhet saktësuar me akt të veçantë nënligjor detyrimin e NjQV-ve lidhur me grumbullimin, magazinimin e përkohshëm dhe transferimin e tyre për trajtim të specializuar. (Neni 43, Pika 1).

Në lidhje me kërkesën për të përfshirë në projektligj listën e mbetjeve të rrezikshme bashkiake sqarojmë se nuk është e mundur të përcaktohet një listë përfundimtare e mbetjeve të rrezikshme sepse mbetjet konsiderohen të rrezikshme në varësi të vetive përbërëse të tyre dhe përzierjeve sipas rastit. Vlerësimi i rrezikshmërisë bëhet në përputhje me shtojcën e ligjit dhe me VKM-në e katalogut të mbetjeve.

Makinat në fund të jetës nuk janë detyrim i bashkive sepse nuk përfshihen në përkufizimin mbetje bashkiake. Përgjegjësia dhe metoda për grumbullimin dhe trajtimin e tyre rregullohet me VKM. NJQV-të kanë detyrimin e grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve bashkiake dhe të rrymave të mbetjeve që u ngarkohen posaçërisht nga projektligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

I.2 Kapacitetet dhe burimet për MIM në nivel vendor

Bazuar në sistemin aktual të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendor, krahasuar me kërkesat e projekt ligjit, ka një qëndrim të njëjtë prej bashkive mbi mungesën e kapaciteteve njerëzore dhe financiare për ngritjen dhe funksionin e një sistemi të tillë MIM.

a) Përballimi i kostove financiare për ngritjen e sistemit për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve është mjaft i vështirë me buxhetin e vetë bashkisë. (Neni 24, Pika 1, germa ç; Neni 27, Pika 1, Pika 3, Neni 32). Ngritja e rrjetit të stacioneve të transferimit (Nenet 32-33) vlerësohet barrë për buxhetet modeste të bashkive, ndaj ato duhen parashikuar si pjesë e mbështetjes së dhënë prej nivelit qendror për ngritjen e sistemit MIM.

Detyrimi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve ekziston në ligjin në fuqi nr. 10 463, datë 22.9.2011 “për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. megjithatë, nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe kredive, ministria përgjegjëse për mjedisin ka mbështetur dhe mbështet bashkitë në ngritjen e rrjetit të menaxhimit të mbetjeve. Për më tepër, miratimi i projektligjit për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit, do ndikojë në uljen e sasisë së mbetjeve që menaxhohen nga bashkitë.

b) Kostot për ngritjen e sistemit të MIM në nivel vendor duhen mbështetur me fonde të veçantë/specifikë prej nivelit qendror. (Neni 28, Neni 29)

c) Fondi i Ekonomisë së Mbetjeve në formën e një fondi financiar publik që mbështet politikën, programet dhe projektet në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve (Neni 29/1) duhet të jete një fond i dedikuar për nevojat e bashkive dhe zonave të mbetjeve për zhvillimin e masave për ekonominë qarkulluese. VKM-ja për administrimin e tij ta garantojë këtë dhe të kufizojë përdorimin e këtij fondi si mbështetje ekonomike për autoritetet qendrore (Neni 28, pika f). zojë përdorimin e këtij fondi si mbështetje ekonomike për autoritetet qendrore (Neni 28, pika f).

Sqarojmë se sipas nenit 29 paragrafi 1 të projektligjit fondi i ekonomisë së mbetjeve është ‘fondi financiar publik që mbështet politikën, programet dhe projektet në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, për Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore.’ Pra si rrjedhojë ky fond është i dedikuar për menaxhimin e mbetjeve dhe për projektet

e autoriteteve vendore. Autoritetet e tjera qendrore, apo vendore, publike apo private nuk mund të përfitojnë nga ky fond.

d) Trajtimi fundor i mbetjeve parashikohet në nivel të zonave të mbetjeve dhe ngritja e impianteve fundorë të trajtimit të mbetjeve parashikohet të mbulohet nga Buxheti i Shtetit (Neni 27, Pika 5). Megjithatë kostot e transportit drejt pikave të trajtimit fundor të mbetjeve dhe pagesa për trajtimin fundor bazuar në sasinë e dërguar të mbetjeve vlerësohen përtej kapaciteteve të buxhetit të shumicës së Bashkive. Projekt ligji duhet të përmbajë parashikime të kontributit të nivelit qendror për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve për këtë trajtim. (Neni 29, Pika 1). Në bazë të ligjit 68/2017 “për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 18, pika 2, niveli i tarifave të shërbimeve publike synon mbulimin e kostos së këtyre shërbimeve. Një pjesë e Fondit të Ekonomisë së Mbetjeve mund të ndahet si kontribut për të mbuluar kostot e trajtimit fundor të mbetjeve bashkiake.

e) Bashkia nuk staf të mjaftueshëm dhe të përgatitur në aspektin teknik (burime njerëzore, njohuri dhe aftësi) për të ngritur dhe menaxhuar një sistem MIM. Ky është një problem më i mprehtë për bashkitë e vogla. (Neni 32)

f) AKEM duhet të parashikojë mbështetjen e NjQV-ve me Udhëzues specifike për MIM. (Neni 22)

g) Projekt ligji duhet të parashikojë kryerjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për planet e mbetjeve në nivel kombëtar, vendor dhe të zonave të mbetjeve.

Si parim i përgjithshëm të ligjit për VSM, planet dhe programet që prekin ndërtimin e disa lloj infrastrukturash të mbetjeve, si infrastrukturat e asgjësimit përfshirë lëndfillin, i nënshtrohen VSM-së. Gjithsesi, për secilin plan mund të vlerësohet nëse VSM është e domosdoshme dhe të përcaktohet kryerja e saj në nenin përkatës.

I.3 Raportimi i të dhënave për mbetjet

a) Mungesa e impianteve fundorë të trajtimit të mbetjeve, për rrjedhojë mungesa e peshimit krijon vështirësi për grumbullimin e të dhënave të sakta për shumë bashki. Projekt-ligji duhet të përmbajë edhe raportimin e të dhënave të grumbulluara prej operatorëve e riciklimit dhe të impianteve fundorë për vetë bashkitë pjesëmarrëse në Zonën e Mbetjeve, sipas rrymave të përcaktuara në projekt ligj. (Neni 72)

Komenti u reflektua, në pikën 3 të nenit 71 të projektligjit.

b) Projekt ligji duhet të qartësojë dhe specifikojë rolin e AKEM dhe AKM lidhur me detyrimin e bashkive për raportimin e të dhënave për mbetjet. Ngritja e sistemit të digjitalizuar të informacionit mjedisor duhet të shmangë raportimin e dyfishtë të dhënave prej NjQV-ve. (Neni 72). Rekomandohet që rezultatet të

konfirmohen/harmonizohen me të dhënat që grumbullohen dhe raportin INSTAT për këtë çështje.

Komenti është reflektuar në nenin 71 të projektligjit, pika 1 përcakton raportimin e të dhënave të subjekteve të pajisura me leje/licencë pranë AKM-së, pika 2 përcakton raportimin e bashkive pranë AKEM.

b) Projekt ligji duhet të përmbajë vlerësimin e Bashkive bazuar në performancë dhe raportimin e të dhënave për treguesit e realizimit të performancës së saj.

Metodologjia e përllogaritjes së arritjes së objektivave nga bashkitë në fushën e menaxhimit të mbetjeve do të përcaktohet me VKM, pas konsultimit me NjQV-të (Neni 13 i projektligjit, pika 2).

d) Projekt ligji duhet të specifikojë edhe detyrimin e NjQV-ve për raportimin e rrymave të mbetjeve të rrezikshme apo rrymave të tjera (si ato elektronike, baterive, makinave në fund të jetës, etj). (Neni 72)

Detajet, formatet e raportimit dhe informacionet që duhet të përmbajë raportimi i të dhënave nga NJQV-të janë të përcaktuara në VKM-në përkatëse nr. 687, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin, dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, i ndryshuar.

I.4 Bashkëpunimi ndër-vendor, zonat e mbetjeve dhe trajtimi fundor i mbetjeve
Bashkëpunimi ndër-vendor i parashikuar për planifikimin e trajtimit fundor të mbetjeve duhet shtrirë në të gjithë aspektet e bashkëpunimit (Neni 26):

Bashkëpunimi ndërvendor është i rregulluar në ligjin nr. 139/2015 “për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 14 të tij dhe është i parashikuar gjithashtu në ligjin 68/2017 “për financat e vetëqeverisjes vendore” në nenet 27-28 të tij.

a) Bashkitë referojnë vështirësi në marrjen e informacioneve për planifikimin dhe menaxhimin në nivel zonal: afatet e ndërtimit, kapacitetet dhe tarifa e depozitimit. Për implantet ekzistuese praktika e deritanishme referon vështirësi në dhënien e informacioneve prej operatorëve të impianteve fundorë lidhur me sasinë e depozituara dhe të ndarë në implant sipas rrymave.

Komenti u adresua, në pikën 3 të nenit 71 të projektligjit.

b) Të qartësohet pronësia mbi implantet fundorë të trajtimit të mbetjeve, kur ato gjenden në territorin e një bashkie të caktuar, së bashku me kushtet e operimit të tyre (Nenet 34-37).

Të gjitha mundësitë dhe format e pronësisë janë të hapura ashtu siç ndodh për të gjitha shërbimet e tjera publike. Neni 26 (1) (dh) parashikon se marrëveshja e bashkëpunimit ndërvendor përcakton edhe pronësinë e infrastrukturës. Nuk ka nevojë të rregullohet pronësia në ligjin e mbetjeve pasi mënyra sesi rregullohet

pronësia është e parashikuar në legjislacione të ndryshme dhe mund të ndryshojë rast pas rasti.

Sqarojmë se pronësia varet nga entiteti që disburson fondet dhe nga marrëdhënia kontraktore:

Nëse ndërtohet me fonde të buxhetit të shtetit pronësia do të jetë e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor mund ti jepet në përdorim;

Nëse ndërtohet me fondet e buxheteve të bashkive pjesë e zonës së menaxhimit të mbetjeve, bashkitë do të jenë bashkëpronare sipas përqindjes së fondeve të derdhura ose autoriteti që administron zonën e menaxhimit të mbetjeve mund të jetë pronar, sipas përcaktimeve të marrëveshjes ndërvendore;

Nëse ndërtohet me formulën PPP do të zbatohen rregullat e kësaj procedure sipas kontratave përkatëse.

c) Të qartësohet përgjegjësia institucionale për hartimin Planeve Zonale të Mbetjeve dhe forma e pjesëmarrjes së bashkive në procesin konsultues (Neni 65). Sqarojmë se sipas nenit 64 “Çdo strukturë administruese e zonave të mbetjeve harton dhe miraton planin zonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin e zonës së mbetjeve”. Kjo do të thotë që nëse ZMM administrohet nga një shoqëri e krijuar nga bashkitë, Plani zonal do të hartohet nga shoqëria; nëse do të administrohet nga një institucion i përbashkët i bashkive do të hartohet nga ky institucion. Bashkitë si organe përbërëse të zonës së menaxhimit të mbetjeve, do të përdorin mekanizmat e tyre të planifikimit sipas ligjit 139/2015 për të shprehur dhe miratuar vullnetin e tyre në secilën bashki përkatëse.d) Për disa bashki vlerësohet kufizues fakti se një bashki mund të jetë pjesë vetëm në një zonë mbetjesh. Për shkak të shtrirjes gjeografike dhe vlerësimit financiar, ti jepet e drejta bashkisë të vendosë në cilën zone mbetjesh do të marrë pjese dhe nëse mund t’i dërgojë mbetjet në më shumë sesa një zonë. (Neni 26, Pika 2).

e)Në marrëveshjen ndër-bashkiake të përcaktohen edhe kriteret e vendosjes së tarifës hyrëse në lëndfill.

Sqarojmë se sipas nenit 26 të projektligjit në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen ndër të tjera:

f) mbledhja e të ardhurave si dhe përdorimi i të ardhurave dhe përfitimeve të tjera;

g) çdo element tjetër që konsiderohet me rëndësi për përmbushjen e qëllimit të menaxhimit të mbetjeve në zonë përkatëse të menaxhimit të mbetjeve;

Pra bazuar në këto dispozita, bashkitë mund të bien dakord të përfshijnë në marrëveshje këtë çështje si dhe çdo çështje tjetër funksionale për zbatimin e qëllimit të marrëveshjes. Duke qenë kjo një kompetencë e bashkive nuk ka nevojë që të përfshihet dhe të përcaktohet në ligj, por duhet të përcaktohet në përputhje

me legjislacionin në fuqi për kompetencat e bashkive në vendosjen e taksave dhe tarifave vendore.

I.5. Zbatimi i kuadrit ligjor dhe sanksionet (Kreu IX) Projekt ligji parashikon një sërë sanksionesh për mos-zbatimin e kërkesave të projekt-ligjit

a) Penalitetet të jenë të zbatueshme vetëm pas periudhës tranzitore që do të përcaktohet me akte nënligjore për fillimin e funksionimit të sistemit të MIM në nivel vendor.

b) Penalitetet të jenë proporcionalë me dëmin mjedisor të shkaktuar, për rastet e mosveprimit apo të veprimit në kundërshti me përcaktimet e ligjit, referuar standardit të miratuar për menaxhimin e integruar të mbetjeve . Në parashikimet për penalitete mund të shtohet edhe mos zbatimi i modelit të kostos.

c) Penalitetet për kryetarin e bashkisë vlerësohen jo proporcionalë për përgjegjësitë e këtij funksioni dhe nuk duhen parashikuar të ngarkuara mbi personin.

d) Në Nenin për kundërvajtjet administrative parashikohet sanksioni ndaj bashkisë, për rastin kur ajo nuk përmbush detyrimin për hartimin e Planit Vendor të MIM dhe/ose rrymave të veçanta të mbetjeve, brenda afateve kohore të përcaktuara.

e) Të parashikohen penalitete edhe për operatorët e impianteve fundorë të trajtimit të mbetjeve, të cilët vonojnë apo nuk japin (nuk përmbushin detyrimin) për të dhënë informacion tek Bashkitë lidhur me sasinë e depozituar të mbetjeve sipas rrymave të përcaktuara në ligj.

f) Të parashikohen sanksione deri në mbyllje të veprimtarisë për operatorët e riciklimit të cilët nuk operojnë sipas standardeve të përcaktuara.

II.1 Mbetjet inerte nga ndërtimi dhe shembjet

a) Bashkitë e kanë të pamundur të adresojnë çështjet e mbetjeve nga inertet e ndërtimit dhe shembjet sidomos lidhur me ngritjen e vendgrumbullimeve në territorin e bashkive, nëse mbetjet nga ndërtimi dhe shembja pranohen nga stacionet e transferimit, (Neni 33/4), ku të bëhet trajtimi i tyre në impiante rajonale. Të shihet mundësia e zgjidhjes së problematikës së trajtimit të inerteve në nivelin e zonave të mbetjeve (Neni 57) duke mbuluar kostot nga buxheti i shtetit.

Sqarojmë se menaxhimi i mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja do të rregullohet me VKM, sipas nenit 57 të Projektligjit.

II.2 Ndarja e mbetjeve në burim dhe trajtimi i mëtejshëm i tyre

a) Disa bashki që kanë filluar ndarjen e mbetjeve në burim, apo grumbullimin e rrymave të mbetjeve për riciklimin referojnë vështirësi në gjetjen e blerësve / operatorë të interesuar për këto produkte. Kjo bëhet edhe më e vështirë për

Bashkitë e vogla që kanë sasi të kufizuara të tyre, për të cilat tërheqja prej operatorëve mbart kosto më të larta transporti (Neni 12, Pika 2)

b) Duhet të përcaktohen dhe mbështeten praktika që mund të ndjekë bashkia pas grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, për të mbyllur ciklin qarkullues.

c) Vështirësi paraqesin veçanërisht ato rryma mbetjesh për të cilat nuk ka industri ricikluese brenda vendit tonë si psh. riciklimi i qelqit.

d) Ndonëse ka disa nisma pozitive për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio (organike) në disa Bashki të vendit, një pjesë e madhe vlerësojnë se ndërtimi i pikave të grumbullimit dhe trajtimit të tyre është i vështirë për shkak të kostove të larta (që rrjedhin prej sasive të mëdha të këtyre mbetjeve). Kostot e trajtimit të këtyre mbetjeve janë më të larta sesa përfitimi ekonomik prej shitjes së produktit pas trajtimi të mbetjeve bio. (Neni 48)

e) Miratimi i kuadrit ligjor për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit dhe përcaktimi i skemës së grumbullimit në përmbushje të detyrimit prej këtij ligji, pritet të çojë në rritjen e sasisë së grumbulluar të mbetjeve të riciklueshme, e për rrjedhojë të zvogëlojë sasinë e përgjithshme të mbetjeve. Zbatimi efektiv i këtij parimi dhe kërkesave të ligjit përkatës do të ndihmojë edhe Bashkitë duke ulur sasinë e mbetjeve dhe duke harmonizuar përpjekjet me operatorët për trajtimin e rrymave të mbetjeve për riciklim (Neni 27).

II.3 Mbetjet e rrezikshme bashkiake dhe rrymat të tjera mbetjesh

a) Skemat e grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme të ndara nga mbetjet bashkiake duhet të përcaktohen, dhe ngrihen vetëm pasi të jetë përcaktuar mënyra dhe vendi i trajtimit fundor të tyre. Përcaktimi i pikave të përkohshme apo fundore të grumbullimit është parakusht për të vlerësuar dhe planifikuar skemën e grumbullimit në territorin e Bashkisë. (Kreu IV)

Mbetjet e rrezikshme të cilat nuk janë mbetje bashkiake, në bazë të nenit 4 pika 18 e këtij projektligji, nuk janë kompetencë e bashkive. Ato rregullohen nga kuadri ligjor përkatës. Modalitetet e grumbullimit të mbetjeve të rrezikshme bashkiake përcaktohen nga Këshilli Bashkiak, duke u bazuar në kërkesat e këtij projektligji dhe të aktit nënligjor përkatës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bashkiake.

b) Bashkitë referojnë vështirësi në kontrollin e territorit lidhur me depozitimin ose hedhjen jo të rregullt/paligjshme të mbetjeve të rrezikshme prej operatorëve të ndryshëm si serviset e makinave (vajrat, mbetje plastike etj.) në kontejnerët bashkiakë (Neni 27, Pika 4).

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme të cilat nuk janë mbetje bashkiake, në bazë të përkufizimit në nenin, 4 pika 18 e këtij projektligji, nuk është kompetencë e bashkive. Ndërsa mbikëqyrja e territorit të tyre është detyrë e bashkive, bazuar në

ligjin 139/2015, neni 66, shkronja b, ku citohet se administrata e njësise administrative mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin.

c) Disa bashki me sipërfaqe të konsiderueshme me aktivitet bujqësor kanë shprehur shqetësimin e mbetjeve kimike bujqësore, të cilat përzihen me mbetjet bashkiake apo hidhen në territor. Grumbullimi dhe trajtimi i duhur këtyre mbetjeve të specifikohet në mënyrë të veçantë. (Kjo kategori nuk listohet në Nenin 3: Përrjashtimet, por nuk ka specifikime në asnjë nen që rregullon rrymat e mbetjeve të rrezikshme).

Sqarojmë se mbetjet nga bujqësia nuk përfshihen në përkufizimin e mbetjeve bashkiake dhe nuk janë kompetencë e bashkive. Ato duhet të rregullohen nga legjislacioni i posaçëm. Ndërsa mbikëqyrja e territorit të tyre është kompetencë e bashkive, siç është sqaruar në pikën më sipër.

d) Në të njëjtën mënyrë duhet specifikuar edhe ndarja dhe grumbullimi i veçantë mbetjeve të rrezikshme shtëpiake (mbetje farmaceutike të prodhuara në familje, kimikate, bateri, etj) (Neni 43, pika 1 dhe 2).

Këto kërkesa dhe detaje do të përcakohen me VKM-në përkatëse për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, e cila do të amendohet për tu perputhur me këtë ligj.

e) Disa bashki referojnë probleme me KLSH për llogaritjen e kostove për rrymat e mbetjeve të veçanta si mbetjet voluminoze (që dalin nga familjet apo njësi shërbimesh), të cilat grumbullohet si pjesë e mbetjeve bashkiake. Specifikimi i nën-ndarjeve të tilla është i nevojshëm për të mundësuar dhënien e shërbimit dhe për llogaritjen e kostove në nivel vendor për të gjitha kategoritë e gjeneruara të mbetjeve bashkiake, në përputhje me kërkesat e ligjit.

Në bazë të nenit 4, pika 18 e këtij projektligji, mbetjet e vëllimshme si mobilje, dyshekët dhe të ngjashme, janë mbetje bashkiake, në kategorinë e mbetjeve shtëpiake.

II.4 Mbledhja e kundërvajtjeve administrative

a) Bashkitë paraqesin vështirësi në mbledhjen e kundërvajtjeve administrative, për shkak të mungesës së sistemit, mungesës së identifikimit të ndotësve, etj. Për rrjedhojë, duhet qartësuar dhe specifikuar mënyra e grumbullimit të tyre (Neni 29, pika 2, gërma a).

Rasti kur krijuesi i mbetjeve nuk identifikohet, është adresuar në pikën 4 të nenit 27 të këtij projektligji.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka sugjeruar që nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve që do të krijohet si dhe të

krijohen regjistra dhe të grumbullohen të dhëna, sugjerojmë që, të parashikohet krijimi i bazës së të dhënave për këtë sistem, në zbatim të pikës 1, të nenit 4 të ligjit Nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Gjithashtu, në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 4 të ligjit Nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, akti i krijimit të bazës së të dhënave shtetërore duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe shteruese elementet si më poshtë:

- Institucionin administrues të bazës së të dhënave shtetërore;
- Të dhënat parësore dhe dytësore;
- Dhënësin/dhënësit e informacionit;
- Ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;

Nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara. Në kuadër të procesit të digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve, në projektaktin e propozuar sugjerojmë që, të parashikohen shërbimet që do të akomodohen në këtë sistem dhe të specifikohet që këto shërbime do të jenë online. Sqarojmë se sistemi i Integruar i Menaxhimit të Mbetjeve do të jetë pjesë e Sistemit të Informacionit Mjedisor ashtu si referohet në Nenin 45 pika f e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Paralelisht me reflektimin e komenteve të ministrive të linjës duke u nisur nga gjendja aktuale dhe problematikat e shumta të vërejtura në menaxhimin e integruar të mbetjeve nga bashkitë, sidomos me fillimin e sezonit turistik veror, u vlerësua se është e nevojshme një qasje e re inovative për menaxhimin e integruar të mbetjeve në vend.

Në këtë kontekst u rivlerësua dhe roli i AKEM si një institucion i ri, i ngritur në 2024, që ka një rol të rëndësishëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve në vend. Krijimi i AKEM erdhi në një kohë kur menaxhimi i mbetjeve është në një moment shumë të vështirë: kontratat koncesionare për inceneratorët në Tiranë, Elbasan e Fier kanë dështuar dhe këto impiante janë nën sekuestro nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë.

Praktikat Ndërkombëtare në Menaxhimin e Mbetjeve dhe përvoja evropiane evidenton një larmi modelesh në menaxhimin e mbetjeve urbane, ku vërehen dy prirje kryesore: Ofrimi i shërbimit nga ndërmarrje publike lokale/rajonale, shpesh në formën e shoqërive aksionare në pronësi të bashkive dhe pjesëmarrja e sektorit privat përmes kontratave koncesionare apo partneriteteve publik-private, nën mbikëqyrjen e autoriteteve publike.

Në fillim të këtij viti në prill 2025, Këshilli i Ministrave i ka deleguar AKEM-it përgjegjësinë si Autoritet Kontraktues për kontratën e inceneratorit të Tiranës.

Gjithashtu së fundi me VKM Nr. 338 date 19.06.2025 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, AKEM ka një rol të ri për operimin dhe administrimin e vendepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte.

AKEM është caktuar si përfaqësues i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në dy projekte të rëndësishme investimesh që po realizohen në 7 zona të menaxhimit të mbetjeve (nga 10 zona mbetjesh që ka aktualisht në vend) me financim të BE-së, KfË dhe të qeverisë shqiptare.

Në këtë kontekst, pas një vlerësimi gjithëpërfshirës dhe shumë dimensional në lidhje me formën organizative dhe juridike duhet të ketë AKEM, si një institucion i identifikuar tashmë për të marrë detyra operative mjaft të rëndësishme në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së mbetjeve në vend, u rishikuan dhe riformuluan disa dispozita të projektligjit:

Në nenin 15 “Përgjegjësitë e menaxhimit të integruar të mbetjeve” u shtua dispozita që parashikon se AKEM është përgjegjës për infrastrukturën fundore të trajtimit të mbetjeve që është në administrimin e tij.

Në nenin 20 “Institucionet përgjegjëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve” në të njëjtën logjikë u shtua dispozita për AKEM si menaxhues i infrastrukturës fundore të trajtimit të mbetjeve që ka në administrim.

Në nenin 22 Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, duke marrë parasysh praktikën e vendeve europiane si dhe shembujt e kompanive ekzistuese shtetërore, si OSHEE dhe OST, që operojnë në sektorë të ngjashëm infrastrukture, propozohet që AKEM duhet të evoluojë në formën e një shoqërie aksionare shtetërore (sh.a.). Më tej neni parashikon dispozita që lidhen me zhvillimin, koordinimin dhe administrimin e infrastrukturës së rrjetit kombëtar të impianteve të trajtimit të mbetjeve.

Njëkohësisht në nenin 24 bashkitë janë përcaktuar përgjegjësitë e bashkive për organizimin dhe funksionimin e ndarjes së mbetjeve në burim, grumbullimin e diferencuar dhe transportin në përputhje me dokumentat planifikues në fuqi. Po kështu është harmonizuar dispozita për bashkëpunimin ndërvendor, duke përfshirë dhe AKEM në këtë kontekst. Po në këtë linjë në kontekstin e kostove për menaxhimin e integruar të mbetjeve AKEM planifikon, projekton, koordinon dhe administron rrjetin kombëtar të impianteve të trajtimit të mbetjeve, në të gjitha fazat e zhvillimit të tij që përfshijnë ndërtimin, operimin, administrimin dhe mbylljen e tyre.

AKEM përjashtohet nga të gjitha detyrimet për garancitë financiare të lëndfillit.

Në përfundim projektligji parashikon dy dispozita kalimtare që lidhen me:

- periudhën e transformimit të AKEM në shoqëri aksionare (sh.a.); dhe
- transferimin e infrastrukturës fundore të trajtimit të mbetjeve në pronësi shtetërore në administrim të AKEM.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” sjell detyrime financiare, të cilat në mënyrë të detajuar janë analizuar tek dokumenti i RIA-s për këtë projektligj.

Kostoja për grumbullimin dhe transferimin e mbetjeve është përcaktuar në buxhetin bashkiak si një shumë totale e trashëguar zakonisht nga viti i kaluar. Kostoja e llogaritur në total për opsionin e preferuar mbi efektet financiare gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kosto totale në milion lekë, çmimet aktuale, terma nominalë) është për vitin e parë 13,098 milion lek, për vitin e dytë 14,612 milion lek dhe për vitin e tretë 10,726 milion lek.

Po ashtu, do të krijohet një mekanizëm i ri financiar për të rritur mbështetjen për ngritjen e infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor dhe kombëtar dhe ky mekanizëm do të administrohet nga Ministria përgjegjëse për mjedisin nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve. Mekanizmi financiar do të mbështetet në fondet e siguruar nga Buxheti i Shtetit, nga donatorë të huaj dhe vendas dhe burime të tjera të ligjshme.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI